REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr .9199, datë 26.02.2004

PËR

PRODHIMIN, PERPTUNIMIN,ÇERTIFIKIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE "BIO"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutes, me propozimin e Keshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPERISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Ligji është:
a) nxitja e prodhimit organik në vend,
b) krijimi i kuadrit ligjor të nevojshëm
c) përcaktimi i kushteve të prodhimit, përpunimit, transportit, çertifikimit dhe kontrollit të produkteve bujqësore dhe atyre ushqimore me prejardhje bimore dhe shtazore, që prodhohen, përpunohen ose/dhe importohen e tregëtohen si produkte "Bio".

NENI 2

Përkufizime:

Në kuptim të këtij ligji:

1. "Komisioni Shtetëror **i Prodhimit Organik"** (KSHPO), është autoriteti përgjegjës, i cili miraton dhe mbikqyr veprimtarinë e organizmave çertifikues.

2. **“Çertifikim”** është përkufizimi i dhënë në ligjin nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standartizimin”

3. **“Etiketim”** është çdo fjalë, markë tregëtare, emër tregëtar, përmbajtje piktoreske dhe shenja në amballazhim, dokument, shënim, etiketë, kapak ose qafore, që shoqëron ose i referohet një produkti të specifikuar në nenin 9 të këtij ligji.

4. **“Inspektim”** është proçedura e kontrollit dhe verifikimit, e realizimit të kushteve të prodhimit organik, të përcaktuara në këtë ligj, e realizuar nga trupat inspektuese.

5. **“Leje e përkohshme”** është leja që jepet nga KSHPO-ja, me propozimin e organizmit certifikues, për një periudhë kohe të caktuar, për përdorimin e materialeve që nuk përfshihen në Anekset II dhe III të këtij ligji.

6. **“Notifikim”** është proçedura e njoftimit në KSHPO për njësitë e prodhimit organik dhe njohjes së konformitetit të produkteve organike, të propozuara nga organizmat çertifikues.

7. **“Njesia e prodhimit organik”** është njësia ose ndërmarja apo ferma që ushtron një veprimtari prodhimi, përpunimi, çertifikimi dhe tregëtimi të produkteve “Bio”, në përputhje me këtë ligj.

8. “Organizëm çertifikues” është çdo organizëm shtetëror, privat, vendës apo i huaj i cili vërteton përputhshmërinë e produkteve, proçeseve, shërbimeve dhe të sistemeve të cilësisë, sipas kërkesave të standarteve dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në këtë ligj.

9. “Organizma Gjenetikisht te Modifikuara” (OGjM) janë të gjithë organizmat e gjallë, materiali gjenetik i të cilave është krijuar nëpërmjet manipulimit gjenetik, jashtë rrugëve natyrore të shtimit.

10. “Periudhë konvertimi” është koha e domosdoshme për të kaluar nga sisteme të tjera prodhimi në sistemin e prodhimit organik.

11. “Përbërësit” janë substancat e përdorura gjatë përpunimit të produktit duke perfshirë dhe shtesat ushqimore

12. “Produkte “Bio”” janë të gjitha produktet e rrjedhura nga prodhimi organik.

13. “Prodhime shtazore” janë prodhimi i kafshëve të mbarështuara, i kafshëve shtëpiake (përfshirë edhe insektet), si dhe speciet ujore, të kultivuara në ujrat e ëmbla dhe të kripura. Produktet e gjuetisë dhe të peshkimit nuk përfshihen në prodhimet organike.

14. “Prodhime organike” janë të gjitha veprimet e përfshira për prodhimin e produkteve “Bio”, në mbështetje të përdorimit harmonik të kushteve të mjedisit dhe të kryera në përputhje me rregullat e përshkruara në këtë ligj.

15. “Tregëtim” është ruajtja, reklamimi, njohja, shpërndarja dhe çdo formë tjetër e zakonshme e vendosjes në treg, dyqane, supermarket ose në restorante e produkteve për realizimin e qëllimit.

16. “Trupa inspektuese” janë inspektorët e miratuar nga KSHPO-ja për kryerjen e inspektimit.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE PERGJEGJËSE

NENI 3

Komisioni Shtetëror i Prodhimit Organik

1. Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit ngrihet dhe funksionon KSHPO-ja, që ushtron kontroll vjetor mbi organizmat çertifikues.

2. Përbërja, funksionimi, të drejtat dhe detyrat e KSHPO-së përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

NENI 4

Organizmi Çertifikues

1. Struktura, funksionimi, kriteret e pranimit, të vlerësimit të dokumentacionit të nevojshëm dhe të detyrimeve të organizmave çertifkues vendas përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.
2. Kriteret e pranimit, vlerësimit të dokumentacionit të nevojshëm dhe të detyrimeve, të miratuara për organizmat çertifikues vendas , janë të vlefshme dhe për organizmat çertifikues të huaj.
3. Organizmat çertifikues të huaj e ushtrojnë veprimtarinë në këtë fushë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi.

NENI 5

Trupat Inspektuese

1. Trupat Inspektuese të njësive të prodhimit organik janë njësi të pavarura nga organizmi çertifikues dhe kanë detyrë kontrollin për zbatimin e kushteve të përcaktuara në këtë ligj. Detyrat bazë të inspektimit dhe masat e trupave inspektues janë dhënë në Anekset III dhe IV të këtij ligji.

2. Të dhënat e inspektimeve, të kryera nga trupat inspektuese, i paraqiten Organizmit Çertifikues i cili ka të drejtën e vendimmarrjes. Ky organizëm njofton për vendimet e marra KSHPO-në.

3. Analizat e mostrave të marra nga Trupa Inspektuese bëhen në laboratorë të akredituar vendas ose të huaja, privat ose shtetëror.

KREU III

ÇERTIFIKIMI DHE LEJET E PËRKOHSHME

NENI 6

Çertifikimi i prodhimit organik

Organizmi Çertifikues bën çertifikimin e njësive të prodhimit organik në përputhje me modelet "A" dhe "B" të Aneksit V të këtij ligji. Çertifikatat e modelit "B" jepen kur produkti eksportohet në Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian.

NENI 7

Lejet e përkohshme

1. KSHPO-ja jep leje të përkohshme për:

    a) përdorimin e materialeve të palistuara në Aneksin II dhe III të këtij ligji,
    b) përdorimin e materialeve me origjinë jo bujqësore (ndihmesat teknologjike dhe shtesat) ose me origjinë bujqësore joorganike për përpunim, të palistuara në shkronjat "D" dhe"E" në Aneksin II.

2 KSHPO-ja mbikqyr dhe rishikon listën dhe kushtet e përdorimit të materialeve të listuara në Anekset II dhe III ,në përputhje me ndryshimet e Rregulloreve të Komunitetit Europian dhe me propozimin e organizmit çertifkues, shpall vendimet për lejet e përkohshme.

KREU IV

KUSHTET E PRODHIMIT ORGANIK DHE PËRPUNIMIT

NENI 8

Kushtet specifike të prodhimit organik

Prodhimi organik dhe përpunimi i produkteve organike realizohen në kushte specifike, të përshkruara si më poshtë:

a) Prodhimi i bimëve, mbarështimi i kafshëve dhe produktet me origjinë bimore e shtazore realizohen sipas kërkesave të paraqitura në Anekset I, VII dhe VIII të këtij ligji.
b) Materialet e lejuara për përmirësimin e tokës dhe bimëve, për ushqimin e mbrojtjen e bimëve, kundrejt dëmtuesve dhe sëmundjeve dhe kushtet për përdorimin e tyre janë dhënë në Aneksin II.
c) Kërkesat për përdorimin e substancave të caktuara, me origjinë jo bujqësore (shtesat dhe ndihmësit teknollogjik) ose me origjinë bujqësore jo-organike janë dhënë në shkronjat 'A", "B" dhe ,"C" të aneksit VI, të këtij ligji.

Ç. Mund të përdoren farat dhe materialet e riprodhimit vegjetativ vetëm për prodhime që rrjedhin plotësisht nga prodhimi organik. Farërat dhe materialet e riprodhimit vegjetativ quhen me origjinë organike, nëqoftëse bimët, prindër të tyre, janë prodhuar në përputhje me paragrafet (a) dhe (b) të këtij neni, për të paktën një brez dhe në rastin e kulturave shumëvjeçare, të paktën dy periudha vegjetacioni.

KREU V

KUSHTET PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE "BIO"

NENI 9

Përdorimi i etiketave

Etiketa e vënë mbi produktet "Bio" duhet të paraqesë natyrën e vërtetë të produktit. Ajo shkruhet në gjuhën shqipe, pa përjashtuar përdorimin e gjuhëve të tjera. Gjithashtu, si kërkesë të detyrueshme, etiketa përmban treguesit e prodhimit organik dhe ndërtohet sipas kërkesave të mëposhtëme:

a. termi "Bio", si tregues i detyrueshem që i referohet prodhimit organik, duhet të përdoret në produktet dhe dokumentat që e shoqërojnë.
b. Etiketimi në përputhje me shkronjën „a" të këtij neni, mund të përdoret vetëm për produktet e prodhuara në përputhje me rregullat e dhëna në nenin 8 të këtij Ligji.
c. treguesi që përfshin emrin e organizmit çertifikues, që ka kryer inspektimin e fundit.

ç. Treguesit se produktet e importuara janë mbuluar nga skema e inspektimit të vendeve nga vijnë, jepen në shkronjën „A" të aneksit V të këtij ligji. Në shkronjën „B" të aneksit V janë dhënë dhe logot e tyre.
d. Reklama e produkteve të jetë në përputhje me etiketimin.

NENI 10

Referimi i metodave të prodhimit

1. Etiketa dhe reklama e një produkti do tu referohen metodave të prodhimit organik vetëm kur;

a) tregues të tillë dëshmojnë qartë se janë të lidhur me një metodë të prodhimit organik,
b) produkti është prodhuar dhe tregëtuar në perputhje me rregullat e dhëna në këtë ligj,
c) produkti nuk ka qenë subjekt i trajtimeve duke përfshirë përdorimin e rrezatimit të jonizuar,
d) produkti nuk është gjenetikisht i modifikuar.

2. Etiketa dhe reklama e një produkti, të përbërë nga shumë përbërës dhe të përpunuar, u referohen metodave të prodhimit organik vetëm kur;

a) 95% e masës së përbërësve me origjinë bujqësore (bimore dhe blegtorale) të produktit janë ose rrjedhin nga produkte të prodhuara dhe të tregëtuara në përputhje

me rregullat e dhëna në këtë ligj, ndërsa diferenca *5%*, nuk sjell ndikim në standartin e produktit. Baza e llogaritjes është pesha e plotë përpara përpunimit dhe jo produkti përfundimtar,

b) produkti përbëhet vetëm nga substancat e listuara në seksionin "A' të aneksit VI, si përbërës me origjinë jo-bujqësore dhe gjatë përpunimit të tij janë përdorur vetëm substanca të listuara në seksionin 'B" të Aneksit VI, kur justifikohet që pa këto produkte ai nuk mund të prodhohej,

c) produkti përmban si përbërës me origjinë bujqësore jo-organike vetëm substancat e listuara në Seksionin "C" te Aneksit VI,

ç) produkti ose përbërësit e tij nuk u janë nënshtruar trajtimeve, duke përfshirë përdorimin e rrezatimit të jonizuar gjatë përpunimit (duke perfshirë përpunimin e përbërësve),

d) produkti nuk përmban OGjM ose produkte që rrjedhin nga prodhimi i këtij tipi.

NENI 11

Etiketa dhe reklama e produkteve me shumë përbërës

Etiketa dhe reklarna e një produkti me shumë përbërës, i përgatitur nga përbërës që pjesërisht nuk plotësojnë kërkesat e shkronjës "a" pika 2 të nenit 10 të këtij ligji, mund tu referohen metodave të prodhimit organik me kusht që:

a. të paktën 70% e përbërësve me origjinë bujqësore plotësojnë kërkesat e dhëna në shkronjën "a" pika 2 të nenit 10.
b. produkti plotëson kërkesat e dhëna në shkronjat "a„ dhe "d" pika 2 të nenit 10 . dhe pjesa e mbetur e përbërësve nuk është në sasinë dhe cilësinë e duhur,
c. treguesit që u referohen metodave të prodhimit organik, u referohen, qartësisht, vetëm përbërësve me origjinë bujqësore, organike,
ç. përbërësit dhe nivelet relative të tyre vendosen në listën e përbërësve, në rendin zbritës në peshë.
d. Treguesit në listën e përbërësve shkruhen me shkronja të njëjta, me të njëjtën ngjyrë, madhësi dhe mënyrë të njëjtë.
dh. për referencat e përmendura më lart mund të përdoret treguesi "X për qind „ i përbërësve me origjinë bujqësore ,që janë prodhuar në përputhje me rregullat e metodave të prodhimit organik.

NENI 12

Etiketa e produktit në konvertim

1. Në etiketën e produktit tregimi i konvertimit në prodhimin organik mund të përdoret nëse produkti përmban vetëm një përbërës me origjinë bujqësore dhe:
   a) plotëson të gjitha kërkesat me përjashtim të periudhës së konvertimit dhënë në aneksin I,
   b) periudha e konvertimit është jo më pak se 12 muaj përpara hedhjes së tij në treg,
   c) etiketa e produktit në konvertim duhet të dallohet prej konsumatorit nga produkti "Bio" i cili plotëson kërkesat e këtij ligji

ç. trupi inspektues inspekton dhe verifikon plotësimin e këkesave të shkronjave (a) dhe (b) të pikës 1 të këtij neni.

2. Në etiketen e këtij produkti duhet të përdoret termi "produkt në proçes konvertimi", i cili duhet të dallohet në stil ose ngjyrë nga shënimet e tjera në etiketë. Në tekst, termi "Bio" nuk duhet të mbindriçohet.

KREU VI

Kundërvajtjet Administrative

NENI 13

Në kuptim të këtij Ligji, shkeljet që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative, si me poshtë:

a. Moszbatimi i rregullave të prodhimit bimor, shtazor në nivel ferme. (Aneksi I shkronjat A, B dhe C)
b. Moszbatimi i rregullave të plehërimit, pasuruesve të tokës dhe pesticideve. (Aneksi II)
c. Moszbatimi i regullave të magazinimit. (Aneksi III)
ç. Moszbatimin e rregullave të tregëtimit të produkteve "Bio" Aneksi III
d. Mosrespektimi i normave maksimale të kafshëve për një ha/ tokë për prodhimin e plehut organik, ekuivalent me 170 kg N/ha vit. (Aneksi VII)
dh. Mosrespektimi i normave të sipërfaqeve normale për mbajtjen e specieve të ndryshme të kafshëve. (Aneksi VIII)
e. Mosrespektimin e rregullave te inspektim-çertifikimit te parashikuara ne kete ligj

NENI 14

Sanksionet

Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 13 të këtij ligji, ndërmerren sanksionet e mëposhtme:

1 . Organizmi Çertifikues për shkeljet e parashikuara në shkronjat ,,a'', ,,b'' , ,,c'' , ,,d'' dhe ,,dh'', merr masat e mëposhtëme:

a. analizë shtesë, b. inspektim shtesë,
c. rikthim (ulje) të fazës së çertifikimit, pas rezultateve të analizës dhe inspektimit shtesë, ç. zhvlerësim të produktit ose pjesës së mallit pas analizës dhe inspektimit shtesë,
d. pezullim i çertifikimit dhe në rast përsëritje, ndërprerjen e kontratës së bashkëpunimit

2. KSHPO-ja merr masat e mëposhtme:

a) Për shkeljet e parashikuara në shkronjën „c" , çvlerësim të produktit (mallit) ose pjesës

së mallit.

b) Për shkeljet e parashikuara në shkronjën "ç ', bllokim të mallit dhe analizë të mostrës së tij dhe në rast shkelje gjobe në masën 50 mijë deri në 100 mijë lekë

c) Për shkeljet e parashikuara në shkronjën "e", pezullim të çertifikimit dhe në rast përsëritje, zgjidhje e kontratës së bashkëpunimit

NENI 15

Proçedurat e kundërvajtjes administrative

1. KSHPO-ja dhe Organizmi Çertifikues kanë të drejtë të vendosin masa administrative, të përcaktuara në nenet 3 dhe 4 të këtij ligji.

2. Mënyra e vjeljes së gjobës dhe shpërndarja e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit
3. Kundër vendimit të masës së dhënë, mund të bëhet ankim me shkrim, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit tek Kryetari i KSHPO-së sipas proçedurave të përcaktuara në ligjin nr.7697 datë 07.04.1993 "Për kundravajtjet administrative".

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE

NENI 16

1. Nëqoftëse fara ose materiali tjetër riprodhues nuk plotëson kërkesat e këtij ligji, duhet të përdoret vetëm me miratimin e organizmit çertifikues.
2. Materialet e paketimit, të prodhuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që janë në përputhje me kërkesat e tij, mund të përdoren deri në 2 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 17

Kërkesat e këtij ligji, në mbështetje të Rregullores së Bashkimit Europian nr. 2092/91, datë 24.6.1991 "Në prodhimin organik të produkteve bujqësore dhe treguesit që i referohen produkteve bujqësore dhe produkteve ushqimore", përbëjnë kërkesat minimale për zbatim, në sistemin e prodhimit "Bio"

NENI 18

Ngarkohet Këshilli i Ministrave, të nxjerrë aktet nënligjore përkatëse në zbatim të neneve 3, 4 dhe l5 të këtij ligji.

NENI 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKSI I

PARIMET E PRODHIMIT ORGANIK NË NIVEL FERME (NDËRMARRJE)

A.Bimët dhe produktet bimore

1. Parimet e dhëna në këtë Shtojcë normalisht duhet të zbatohen në ngastra gjatë një periudhe transformimi të paktën 2 vjet përpara mbjelljes ose në rastin e bimëve shumëvjeçare të ndryshme nga livadhet, të paktën 3 vjet përpara vjeljes së parë të produkteve. Organizmi inspektues, me aprovimin e autoritetit kompetent, duhet të vendosë, në raste të caktuara për shtyrjen ose reduktimin e kësaj periudhe, duke patur parasysh përdorimin e mëparshëm të ngastrave.
Në veçanti, periudha e transformimit mund të reduktohet në minimumin e mundshëm, në rastet kur ngastrat kanë qenë trajtuar me një produkt të papërfshirë në Shtojcën 11, pjesa B si pjesë e skemës së kontrollit të dëmtuesve dhe sëmundjeve.
Reduktimi i periudhës së transformimit duhet të merret në konsideratë kur:

- ngastrat janë transformuar ose janë duke u transformuar në bujqësi organike

- degradimi i pesticideve duhet te rezultojë në nivel të papërfillshëm në tokë, kur flitet për bimë shumëvjeçare,

-- Produktet e vjela pas trajtimit nuk do te shiten duke përdorur referencën e prodhimit organik

2. 1. Pjelloria dhe aktiviteti biologjik i tokës duhet të mbahet ose të rritet, me rastin më të parë, nga:

(a)kultivimi i leguminozeve, plehërimeve të gjelbëra ose bimëve me sistem rrënjor të thellë me një program të përshtatshëm të qarkullimit shumëvjeçar.

(b) Futja e plehërimit shtazor nga produktet organike, pika 7.1, të kësaj shtojce;

(c) Futja e materialeve të tjera organike, të përbëra ose jo, nga ndërmarrjet që prodhojnë në përputhje me rregullat e kësaj shtojce.

2.2. Plehra të tjera organike ose minerale, të përmendura në shtojcën II, fragmentalisht, mund të zbatohen, si plotësues për:

- ushqimin e përshtatshëm të bimës në qarkullim ose kushtet e tokës nuk mund të arrihen me metodat e përshkruara në (a), (b) dhe (c) të nënparagrafit paraardhës,

- në lidhje me produktet e Shtojcës II duke ju referuar plehërimit dhe / ose jashtëqitjes së kafshëve:
këto produkte duhet të përdoren vetëm për shtrirje, në kombinim me plehrimin shtazor sipas pikës 2 (1) (b) mësipër.

2.3. Për aktivizimin e kompostes (përzjerje plehrash) mund të përdoren përgatitje me bazë bimësh ose mikroorganizmash jo gjenetikisht të modifikuara .Të ashtuquajturat "përgatitje biodinamike" nga pluhuri i gurit, plehrat e fermës ose bimëve mund të përdoren për qëllimet e këtij paragrafi dhe paragrafit 2.1.

2.4. Përgatitja e përshtatëshme e mikroorganizmave, jo gjenetikisht të modifikuara, mund të përdoret për përmirësimin e përgjithshëm të kushteve të tokës ose vlefshmërinë e ushqyesve në tokë

ose në bimë, kur nevoja për përdorim të tillë është njohur nga organizmi inspektues ose autoriteti kopetent.

3. Kontrolli i dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të këqia do të bëhet nga kombinimi i masave të mëposhtëme:

- zgjedhja e specieve dhe varieteteve të përshtatëshme;
- program i përshtatshëm qarkullimi;
- proçedurat e kultivimit mekanik,
- mbrojtja e luftuesve natyralë të dëmtuesve nëpërmjet vendimeve favorizuese për to (psh gardhet, vendet e foleve, përhapja e grabitësve),
- djegia e barërave të këqia

Vetëm në rastet e rrezikut të menjëhershëm të bimës mund të përdoren produktet e dhëna në Shtojcën II.

4.Mbledhja e bimëve dhe pjesëve te ngrënëshme, që rriten në mënyrë natyrale në zona natyrale, pyje dhe zona bujqësore, konsiderohet metodë e prodhimit organik me kusht që:

- këto zona nuk janë trajtuar me produkte të tjera përveç atyre në Shtojcën II për një periudhë 3 vjeçare përpara mbledhjes.
- Mbledhja nuk ndikon në stabilitetin e habitatit natyral ose ruajtjen e species në zonën e mbledhjes.

5.Për prodhimin e kërpudhave, mund të përdoren substrate vetëm nëqoftëse ato janë të përbërë nga komponentët që vijojnë:

5. 1. Plehërat e fermës dhe jashtëqitjet e kafshëve (duke përfshirë produktet e përcaktuara në 1 deri 4 të Shtojcës II,

(a) ose nga ndërmarrje që prodhojnë në përputhje me metodën e prodhimit organik;

(a) ose të plotësoj kërkesat e dhëna në Shtojcën II, Pjesa A,

5.2. Produktet me origjinë bujqësore, të tjera nga ato të dhëna në pikën 5.1 (p.sh. kashtë) nga ndërmarjet që prodhojnë në përputhje me metodën e prodhimit organik;

5.3. Turba të patrajtuara kimikisht;

5.4. Dru, i patrajtuar me produkte kimike pas prerjes;

5.5. Produkte minerale të Shtojcës II, Pjesa A, ujë dhe tokë.

B. BLEGTORIA DHE PRODHIMI BLEGTORAL NGA SPECIET E MËPOSHTME:

Gjedhë, Derra, Të leshta, Të dhirta, Njëthundrakë, Shpendë.

1. Parime të përgjithshme

1.1 Prodhimi blegtoral përbën një komponent të aktivitetit të shumë ekonomive bujqësore që praktikojnë bujqësinë organike.

1.2 Prodhimi blegtoral duhet të kontribuojë në ekuilibrin e sistemeve të prodhimit bujqësor nëpërmjet sigurimit të kërkesave ushqimore të bimëve dhe nëpërmjet përmirësimit të lëndëve organike të tokës. Kështu ajo mund të ndihmojë në krijimin dhe ruajtjen e ndërvarësisë bimë-tokë, kafshë-bimë dhe tokë-kafshë. Si pjesë e këtij koncepti, prodhimi pa toka nuk është konform me rregullat e këtij ligji.

1.3 Nëpërmjet burimeve natyrale të ripërtëritshme (plehra organike të kafshëve, perime dhe bimë foragjere), sistemet mbarështuese të bimëve/kafshëve dhe sistemet kullosore lejojnë që pjelloria e tokës të ruhet dhe përmirësohet për një kohë të gjatë dhe të kontribuojnë për të zhvilluar një bujqësi të qëndrueshme.

1.4 Mbarështimi i kafshëve i praktikuar në kuadër të bujqësisë organike, është një aktivitet i lidhur me tokën. Përveç rasteve të autorizuara që përjashtohen në këtë aneks, kafshët duhet të hyjnë në një zonë të lirë dhe numri i kafshëve për njësi të sipërfaqes duhet të jetë i kufizuar për të siguruar një manaxhim të plotë të kafshëve dhe prodhimit bimor për njësi prodhimi, duke minimizuar kështu çdo formë ndotje, në mënyrë të veçantë të ndotjes së tokës, të sipërfaqeve të ndryshme dhe të ujrave. Numri i kafshëve duhet të lidhet ngushtësisht me zonën me qëllim që të shmangen problemet e mbingarkesës dhe erozionit dhe të lejohet përhapja e plehrave organike në mënyrë që të mund të shmanget ndonjë efekt i pafavorshëm mbi mjedisin. Në Seksionin 7 jepen rregulla te detajuara mbi përdorimin e plehrave organike.

1.5 Në fermat blegtorale organike, të gjitha kafshët në një dhe të njejtën njësi prodhimi duhet të rriten sipas rregullave të shtruara në këtë ligj.

1.6 Megjithatë, kafshët të cilat nuk rriten sipas parashikimeve të këtij ligji mund të jenë prezent në ekonomi me kusht që ato të rriten në njësi ku stallat dhe parcelat janë të veçanta nga njësitë që prodhojnë sipas rregullave të kësaj rregulloreje, dhe përfshihen dhe specie të ndryshme.

1.7 Nga kufizimet që rrjedhin nga ky parim, kafshët që nuk janë rritur në përputhje me dispozitat e këtij ligji mund të përdorin, çdo vit për një periudhë te kufizuar kohe, kullotat e njësive që veprojnë në përputhje me këtë ligj, me kusht që kafshë të tilla të vijnë nga mbarështimi ekstensiv dhe numri i krerëve për ha ti korrespondojë 170 kg azot për vit/ha (siç përcaktohet në Aneksin VII të këtij ligji) dhe me kusht që kafshët e tjera të cilat nuk janë subjekt i kërkesave të këtij ligji të mos jenë prezent në këtë kullotë në të njëjtën kohë. Ky kufizim duhet të autorizohet që më përpara nga autoriteti apo organizmi certifikues(i kontrollit).

1.8 Si kufizim i dytë që rrjedh nga ky parim, kafshët e rritura sipas përshkrimeve të këtij ligji duhet të kulloten në toka të përbashkëta, me kusht që:

(a) toka të mos jetë e trajtuar me produkte të ndryshme nga ato të lejuara në Aneksin II të këtij ligji, për të paktën 3 vjet.

(b) kafshët të cilat përdorin toka të tilla, të cilat nuk janë subjekt i kërkesave të këtij udhëzimi, vijnë nga prodhimi ekstensiv, dhe numri i kafshëve për ha ti korrespondojë 170 kg azot në vit/ha siç përcaktohet në Aneksin VII të këtij ligji;

(c) çdo produkt blegtoral i prodhuar nga kafshë të rritura sipas dispozitave të këtij ligji, përderisa përdorin këtë kullotë të përbashkët, nuk do të mund të konsiderohen si produkte organike, të paktën të mund të plotësojë kërkesat e autoritetit apo organizmit inspektues që kafshët janë mbajtur të veçanta nga kafshët e tjera që nuk i pergjigjen kërkesave të këtij ligji.

2. **Konvertimi**

2.1. Konvertimi i tokës i shoqëruar me prodhimin blegtoral organik.

2.1.1 Aty ku një njësi prodhimi konvertohet, e tërë sipërfaqja e njësisë e përdorur për ushqimin e blegtorisë duhet ti pergjigjet rregullave të bujqësisë organike, duke përdorur periudhën e konvertimit të krijuar në pjesën A të këtij Aneksi që lidhet me "Bimët dhe prodhimet bimore".

2.1.2 Si rrjedhim i këtij parimi, periudha e konvertimit duhet të reduktohet në një vit për kullotat, zonat e hapura dhe padoqet të përdorura nga speciet jo-bar-ngrënëse. Kjo periudhë mund të reduktohet në 6 muaj nëse toka të tilla nuk ka, në se kohët e fundit nuk janë trajtuar me produkte të ndryshme nga ato të referuara në Aneksin II të këtij ligji. Ky kufizim duhet të autorizohet nga autoriteti apo organizmi inspektues.

2.2 **Konvertimi i blegtorisë dhe produkteve blegtorale.**

2.2.1. Produktet blegtorale shiten me emërtimin produkte organike(biologjike), vetëm nëse kafshët riten në përputhje me rregullat e shtruara në këtë ligj për një periudhë të paktën:
- 12 muaj në rastin e njëthundrakëve dhe gjedheve per prodhim mishi.
- 6 muaj në rastin e ruminantëve të vegjël dhe derrave.
- 6 muaj në rastin e kafshëve për prodhim qumështi;
- 10 javë për shpendët për prodhim mishi, të sjella në moshën deri tre ditëshe,
- 6 javë në rastin e shpendëve për prodhim vezësh.

2.2.2 Siç rrjedh nga paragrafi 2.2.1 për krijimin e tufave, viçat dhe të imtat për prodhimin e mishit mund të shiten si prodhime organike të ritura gjatë një periudhe tranzitimi me kusht që:

- të vijnë nga mbarështimi ekstensiv,
- të rriten në njësitë e prodhimit organik deri në kohën e shitjes apo therjes, për një periudhë minimalisht prej 6 muaj për viçat dhe për të imtat.
- origjina e kafshëve përputhet me kushtet e shprehura në nëndarjet 4 dhe 5 të paragrafit 3.4.

2.3 Konvertimi stimulues.

2.3.1. Nga kufizimet e paragrafeve 2.2.1, 4.2 dhe 4.4 n.q.s ka konvertim të të gjithë njësisë prodhuese, përfshi blegtorinë, kullotat dhe/ose ndonjë tokë të përdorur për ushqimin e blegtorisë, periudha e konvertimit të përgjithshëm e kombinuar edhe për blegtorinë, kulloten dhe/ose ndonjë tokë e përdorur për ushqimin e kafshëve do të reduktohet në 24 muaj që varen nga kushtet e mëposhtme:

(a) Kufizimet përdoren vetëm për kafshët që ekzistojnë dhe pasardhësit e tyre dhe në të njëjtën kohë dhe për tokat e përdorura për ushqimin/kullotjen e kafshëve para fillimit të konvertimit;

(b) kafshët ushqehen kryesisht me produkte nga njësitë prodhuese.

3. Origjina e kafshëve.

3.1. Në zgjedhjen e racave dhe linjave, duhet të llogaritet dhe kapaciteti i kafshëve për tu adoptuar në kushtet lokale; vitaliteti dhe rezistenca e tyre ndaj sëmundjeve. Përveç këtyre, racat dhe

linjat e kafshëve të zgjidhen për të shmangur sëmundje të veçanta apo probleme shëndetsore që shoqërojnë disa linja apo raca të përdorura në prodhimin intensiv (p.sh sindroma e stresit tek derrat, Sindromi PSE, ngordhjet e papritura, abortimet spontane, lindjet e vështira që kërkojnë operacione çezariane, etj). Perferencë t'ju jepet racave dhe linjave vendase (autoktone-lokale).

3.2 Kafshët duhet të vijnë nga njësitë prodhuese të cilat veprojnë në përputhje me rregullat e tipeve të ndryshme të prodhimit blegtoral të shtruara në nenin 6 të kësaj shtojce. Gjatë gjithë jetës së kafshëve duhet të aplikohet ky sistem prodhimi.

3.3 Kafshët që ekzistojnë në një njësi prodhimi blegtoral që nuk vepron në përputhje me rregullat e kësaj shtojce, mund të konvertohen me një miratim të mëparshëm të trupit/autoritetit inspektues.

3.4 Kur një tufë krijohet për herë të parë dhe kafshët e rritura në mënyrë organike nuk janë të mjaftueshme në numur, kafshët e rritura jo-organikisht mund të sillen në njesitë e prodhimit blegtoral, në varësi të kushteve të mëposhtme:

- zogjtë per prodhimin e vezëve nuk duhet të jenë më shumë se 18 javëshe,
- zogjtë për prodhim mishi (brojler) duhet të jenë më pak se 3 ditëshe në kohën kur largohen nga njësia ku u prodhuan për në njësitë e prodhimit,
- Buajt duhet të jenë më pak se 6 muaj,
- viçat dhe kuajt duhet të rriten sipas rregullave të këtij aneksi dhe menjëherë pas këputjes dhe në ndonjë rast ata duhet të jenë më pak se 6 muaj,
- delet dhe dhitë duhet të rriten sipas rregullave të këtij aneksi, menjëherë pas këputjes dhe në ndonjë rast ata duhet të jenë më pak se 45 ditë,
- gicat duhet të rriten sipas rregullave të këtij aneksi, menjëherë pas këputjes dhe të peshojnë më pak se 25 kg.

3.5 Ky kufizim, i cili duhet të jetë i autorizuar që më përpara nga një trup apo autoritet inspektues, aplikohet për një periudhë tranzitore trevjecare

3.6 Ripërtëritja, rigjenerimi apo remontimi i tufave do të autorizohet nga autoriteti kontrollues kur kafshët nuk rriten në mënyrë organike dhe në rastet e mëposhtme:

(a) mortalitetit të lartë të kafshëve të shkaktuar nga rrethana katastrofike e shëndetsore; (b) zogjtë për prodhim vezësh nuk janë më shumë se 18 javëshe;

(c) shpendët për prodhim mishi janë më pak se 3 ditëshe, dhe derrat menjeherë pas këputjes janë më pak se 25 kg. Rastet (b) dhe (c) autorizohen për një periudhë tranzicioni tre vjeçar

3.7 Në rastin e gicave, zogjve për vezë dhe shpendëve për prodhim mishi, ky kufizim në kohë (tranzicioni) do të ri-ekzaminohet para datës së përfundimit për të parë në se ka vend për ti shtyrë këto afate.

3.8 Maksimumi i kafshëve për remontimin e tufave: në njëthundrakë e gjedh prej 10%, derra dhe të imta prej 20%. Këto kafshë do sillen nga ferma blegtorale të prodhimit jo-organik, për të mbështetur rritjen natyrale dhe për të rigjeneruar tufat kur nuk ka kafshë të rritura në mënyrë organike, dhe vetëm kur autorizohen nga autoriteti apo organizmi kontrollues.

3.9 Përqindjet e vendosura në kufizimet e mësipërme nuk do aplikohen në njësitë e prodhimit me më pak se 10 njëthundrakë apo gjedh, ose me më pak se 5 derra, të leshta apo te dhirta. Për këto njesi, çdo remontim i përmendur më sipër do jetë i kufizuar në një maksimum prej një kafshe në vit.

3.10 Këto përqindje mund të rriten deri në 40% sipas opinionit apo mendimit te autoritetit apo organit inspektues, në raste të veçanta si më poshtë:

- kur ndërmeret një ekstension në shkallë të gjerë;
- kur ndryshohet një racë;
- kur zhvillohet specializimi i një kafshe të re.

3.1 1 Si kufizim i pestë, meshkujt për rnbarështim duhet të sillen nga fermat jo-organike në një fermë blegtorale organike me kusht që kafshët më pas të rriten dhe ushqehen sipas rregullave të vendosura në këtë ligj.

3.12 Kur kafshët vijnë nga njësi që nuk veprojnë në përputhje me nenet e kësaj shtojce, në lidhje me kushtet dhe kufizimet e vendosuara në paragrafet 3.3 deri 3.11 (të mësipërm), periudhat e parashtruara në paragrafin 2.2.1 duhet të shihen nëse prodhimet janë shitur sikur të ishin organike dhe gjatë këtyre periudhave të gjitha rregullat e vendosura duhet të veprojnë në përputhje me këtë shtojcë

3.13 Aty ku kafshët janë marrë nga njësi që nuk veprojnë në përputhje me këtë shtojcë, vëmendje të veçantë i duhet kushtuar masave shëndetsore të kafshëve. Autoriteti inspektues duhet të aplikojë, në varësi të kushteve lokale, masa të veçanta, të tilla si teste për parazitët, dhe periudha karantine.

4. Ushqimi

4.1. Ushqimi synon më shumë të sigurojë një prodhim cilësor se sa maksimizimin e prodhimit, ndërsa plotëson kërkesat ushqimore të kafshëve në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre. Praktikat e majmërisë të autorizuara tani për tani janë reversibile në çdo fazë të proçesit të rritjes. Ndalohet të ushqyerit e detyruar të kafshëve.

4.2 Kafshët duhet të ushqehen me ushqime të prodhuara në mënyrë organike.

4.3 Më tej, kafshët duhet të rriten në përputhje me rregullat e vendosura në këtë Aneks, e preferueshme është përdorimi i ushqimeve nga njësi apo, kur nuk është e mundur, përdorimi i ushqimeve nga njësi apo ndërmarje të tjera në varësi të parashikimeve të këtij ligji.

4.4 Deri ne 30% të formulës së ushqimeve në racione mesatarisht mund të përmbajnë lëndë ushqimore në konvertim. Kur ushqimet në konvertim vijnë nga një njësi e vetë ekonomisë, kjo përqindje mund të rritet në 60%.

4.5 Të ushqyerit e të vegjëlve duhet të bazohet në qumështin natyral, i preferueshëm është qumështi i nënës. Të gjithë të vegjëlit duhet të ushqehen me qumësht natyral për një periudhë minimum që varet nga specia, e cila do jetë 3 muaj për gjedhet dhe njëthundrakët, 45 ditë për të imtat dhe 40 ditë për derrat.

4.6 Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit do të përcaktojë zonat apo rajonet përkatëse, ku praktikohet lëvizja e njerëzve dhe e kafshëve për në zonat kullosore në male, pa paragjykuar të ushqyerit e kafshëve të shtruar në ketë shtojcë.

4.7 Sistemet e rritjes së barngrënësve do bazohen në përdorimin në maksimum të kullotave sipas vlerës së kullotave në periudha të ndryshme të vitit. Të paktën 60% e lendës së thatë në racionet ditore konsiston në foragjeret e freskëta, të thata, të ashpra apo silazh. Megjithatë, autoriteti apo trupi inspektues mund të lejojë një reduktim deri në 50% për kafshët në prodhim qumështi për nje periudhe maksimumi prej 3 muajsh ne fillim te laktacionit.

4.8 Për një periudhë tre vjecare, autorizohet përdorimi i proporcioneve të kufizuara të lëndëve ushqimore konvencionale, ku fermeri nuk është në gjëndje të marri ushqime ekskluzivisht nga prodhimi organik. Përqindja maksimum e ushqimeve konvencionale të autorizuara për vit është 10% në rastin e barngrënësve dhe 20% për specie të tjera. Këto shifra llogariten në mënyrë të përvitshme si përqindje e lëndës së thatë të ushqimeve me origjinë bujqësore. Përqindja maksimum e autorizuar e ushqimeve konvencionale në racionin ditor, përveç periudhës së lëvizjes, duhet të jetë 25%, e llogaritur si përqindje e lëndës së thatë.

4.9 Siç del nga paragrafi 4.8, kur humbet prodhimi foragjer, në mënyrë të veçantë si rezultat i kushtëve të veçanta të motit, autoriteti kompetent shtetëror mund të autorizojë për një periudhë të kufizuar dhe në lidhje me një zonë të caktuar (të veçantë), një përqindje më të lartë të ushqimeve konvencionale ku justifikohet një kufizim i tillë.

4.10 Për shpendët, racioni ushqimor i përdorur duhet të përmbajë të paktën 65% drithëra.

4.11 Ushqimet e ashpra, të freskëta apo të thata, apo silazhi duhet të shtohen në racionin ditor të derrave dhe shpendëve.

4.12 Në sillazh mund të përdoren si aditive vetëm produktet e listuara në shtojcën II, pjesa D, seksioni 1.5 dhe 3.1 dhe ndihmuese të përpunimit.

4. 13 Lëndët ushqimore konvencionale me origjinë bujqësore mund të përdoren në të ushqyerit e kafshëve vetëm n.q.s listohen në shtojcën II, Pjesa C, seksioni 1 (lëndët ushqimore me origjinë nga bimët), në vartësi të kufizimeve sasiore të paraqitura në këtë shtojcë, dhe vetëm nëse ato janë prodhuar apo pregatitur pa përdorimin e solventëve kimik.

4.14 Lëndët ushqimore me origjinë shtazore (nëse prodhohen në mënyrë organike apo konvencionale) mund të përdoren vetëm nëse janë të listuara në shtojcën II, Pjesa C, seksioni 2, dhe në vartësi të kufizimeve sasiore të paraqitura në këtë shtojcë.

4.15 Me qëllim që të plotësohen kërkesat ushqyese të kafshëve, vetëm produktet e listuara në shtojcën II, Pjesa c, seksioni 3 (Lëndë ushqimore me origjinë minerale), dhe pjesa D, seksioni 1.1 (elementet që gjenden në formë gjurme) dhe 1.2 (vitaminat, pro-vitaminat dhe substancat e përcaktuara mirë kimikisht që kanë efekt të njëjtë), mund të përdoren në të ushqyerit e kafshëve.

4.16 Vetëm produktet e listuara në shtojcën II, Pjesa D, seksioni 1.3 (enzimat), 1.4 (mikrorganizmat), 16 (agjentë lidhës, anti-trupat dhe koagolantët), 2 (produkte të caktuara - të veçanta- të përdorura në ushqimin e kafshëve) dhe 3 (lëndë të tjera shtesë në fabrikimin e ushqimeve) mund të përdoren në të ushqyerit e kafshëve për qëllimet e treguara sipas kategorive të përmendura më sipër. Antibiotikët, koksidiostatikët, substancat medicinale, nxitësit e rritjes apo ndonjë substancë tjetër që synon të stimulojë rritjen apo prodhimin nuk do përdoren në të ushqyerit e kafshëve.

4. 17 Ushqimet, materialet ushqyese, aditivët ushqimorë në përbërje të ushqimeve, substanca të tjera shtesë në fabrikimin e ushqimeve dhe produkte të veçanta të përdorura në të ushqyerit e kafshëve nuk duhet të jenë prodhuar nga organizma gjenetikisht të modifikueshem apo produkte që rrjedhin prej tyre.

5. Parandalimi i sëmundjeve dhe trajtimi veterinar.

5.1 Parandalimi i sëmundjeve në prodhimin blegtoral do bazohet në parimet e mëposhtme:

(a) zgjedhja e racave dhe linjave të përshtatshme të kafshëve siç specifikohet në Seksionin 3;
(b) aplikimi i praktikave mbarështuese të përshtatshme në përputhje me kërkesat e çdo specie, që inkurajon, stimulon rezistencë të fortë ndaj sëmundjeve dhe parandalimin e infeksioneve;
(c) përdorimi i ushqimeve me cilësi të lartë, së bashku, me ushtrimet e rregullta fizike dhe lëshimi ne kullotë ndikojnë kështu në stimulimin e mbrojtjes natyrale imunologjike të kafshëve.
(d) sigurimi i një densiteti të përshtatshëm të kafshëve, në mënyrë që të shmanget mbingarkesa dhe ndonjë problem shëndetsor që mund të rrjedhi.

5.2 Parimet e vendosura më sipër, do të kufizojnë problemet shëndetsore të kafshëve, kështu që ato të mund të kontrollohen kryesisht nëpërmjet parandalimit.

5.3 Nëse, pavarësisht prej të gjitha masave të mësipërme, një kafshë sëmuret apo plagoset, ajo duhet të trajtohet menjëherë, nëse është e nevojshme të izolohet në vende të përshtatshme.

5.4 Përdorimi i medikamenteve veterinare në bujqësinë organike do të veprojë konform parimeve të mëposhtme:

(a) Prodhimet fitoterapeutike (p.sh ekstratet bimore - përjashto antibiotikët, esencat, etj), produktet homeopatik (p.sh substancat bimore, shtazore apo minerale) dhe oligoelementët (gjurmë) dhe produktet e listuara në Pjesën C, seksioni 3 i shtojcës II, do jenë në preferencë medikamentet veterinare allopatike të sintetizuar kimikisht ose antibiotikët, me kusht që ndikimi i tyre terapeutik të jetë efektiv për speciet e kafshëve dhe kushtet për të cilat synon trajtimi;

(b) N.q.s përdorimi i produkteve të mësipërme nuk provon ose s'ka të ngjarë të provojë efektivitet në luftimin e sëmundjeve apo plagosjeve, për të shmangur vuajtjet dhe dhimbjet e kafshëve, antibiotikët apo medikamentet veterinare allopatike të sintetizuara kimikisht mund të përdoren nën përgjegjësinë e veterinerit;

(c) Ndalohet përdorimi i medikamenteve veterinare allopatike të sintetizuara kimikisht apo antibiotikët në trajtimet parandaluese.

5.5 Përveç parimeve të mësipërme, do të aplikohen rregullat e mëposhtme

(a) ndalohet përdorimi i substancave për të nxitur rritjen apo prodhimin, (përfshi antibiotikët, koksidiostatikët dhe të tjerë shtesa artificiale për qëllim nxitjen e rritjes) dhe përdorimi i hormoneve apo substancave të njëjta për të kontrolluar riprodhimin (p.sh induktimi apo sinkronizimi i estrusit), apo për qëllime të tjera;

(b) të autorizohen trajtimet veterinare të kafshëve, apo trajtimet e lokaleve, pajisjeve dhe mjeteve, përfshi përdorimin e medikamenteve veterinare imunologjike kur një sëmundje njihet si prezente në një zonë të veçantë në të cilën gjendet njesia prodhuese.

5.6 Kurdo që të përdoren medikamentet veterinare tipi i produktit duhet të regjistrohet në mënyrë të qartë (duke përfshirë treguesit e substancave farmakologjike aktive të përmbajtura në të) sëbashku me detajet mbi diagnozat; përdorimin; metodat e administrimit; zgjatjen e trajtimit dhe periudhën e ndërprejes të përcaktuar në ligj. Ky informacion t'i deklarohet autoritetit apo trupit inspektues përpara tregëtimit të kafshëve apo produkteve blegtorale si të prodhuara organikisht. Kafshët e trajtuara duhet të jenë identifikuar në mënyre të qartë, individualisht në rastin e kafshëve të mëdha; në grup apo individualisht, në rastin e shpendëve dhe kafshëve të vogla.

5.7 Periudha ndërmjetëse midis administrimit të fundit me medikamente veterinare allopatike të një kafshe në kushte normale përdorimi dhe prodhimi i lëndëve ushqimore të prodhuara në mënyrë organike nga kafshë të tilla, duhet të zgjatet gati të dyfishohet periudha e mësipërme e regulluar me ligj, ose në rastin kur kjo periudhë nuk specifikohet, ajo bëhet 48 orë.

5.8 Me përjashtim të vaksinimeve, trajtimeve antiparazitare dhe skemave të çrënjosjes së detyrueshme të krijuar nga shteti, në rastin kur një kafshë apo një grup kafshësh marrin më shumë se 2 ose maksimumi tre prej trajtimeve me medikamente veterinare kimikisht të sintetizuar apo antibiotikë brenda një viti (ose më shumë se një cikël trajtimi nëse jetëgjatësia produktive e tyre është më pak se sa një vit) kafshët që kanë këtë problem, ose prodhimet që rrjedhin prej tyre, nuk mund të shiten sikur të ishin prodhuar sipas këtij aneksi dhe kafshët duhet të ishin vendosur sipas periudhës së konvertimit të parashikuar në Seksionin 2 të kësaj shtojce, në varësi të konsensit të autoritetit apo organizmit të kontrollit/inspektimit.

6. Praktikat e manaxhimit të mbarështimit, transporti dhe identifikimi i produkteve blegtorale.

6. 1 Praktikat zooteknike

6.1.1 Në parim, riprodhimi i kafshëve të rritura në mënyrë organike duhet të bazohet në metoda natyrale. Megjithatë, inseminimi artificial ndalohet. Ndalohen gjithashtu forma të tjera riprodhimi apo të ndihmës (p.sh embrio-transfera)

6.1.2. Veprime të tilla si aplikimi i bandave elastike në bishtin e deleve, prerja e dhëmbëve, prerja apo rregullimi i sqepave apo prerja e brirëve nuk duhet të jenë praktika sistematike në bujqësinë organike. Disa prej këtyre veprimeve mund, sidoqoftë, të autorizohen nga autoriteti apo organi inspektues për motive të sigurisë (p.sh. heqja e brirëve tek kafshët e reja) ose nëse synohet përmirësimi i shëndetit, mirëqënia apo higjena e kafshëve. Veprime të tilla duhet të kryhen në moshë të përshtatshme nga personel i kualifikuar duke reduktuar në minimum vuajtjet e kafshëve.

6.1.3 Kastrimi i kafshëve lejohet me qëllim që të ruhet cilësia e produkteve dhe praktikat e prodhimit tradicional (derrat e tipit për mish, demat e rinj, gjelat për mish) por vetëm sipas kushteve të vendosura ne frazën e fundit të paragrafit 6.1.2.

6.1.4 Ndalohet mbajtja e lidhur e kafshëve. Megjithkëtë, siç del nga ky parim, autoriteti apo organi inspektues, mund të autorizojë këtë praktikë për kafshë të veçanta sipas motivacionit të një operatori, kur kjo është e nevojshme për arsye sigurie dhe mirëqënie dhe një lidhje e tillë është e kufizuar vetëm për një periudhë të kufizuar kohe.

6.1.5 Siç del nga ajo që parashtrohet në paragrafin 6.1.4, lidhja e gjedhëve mund të praktikohet me kusht që të sigurohen ushtrime të rregullta fizike dhe rritja të jetë në një linjë me kerkesat e mirëqënies së kafshës me zonat komforte të shtresës si në manaxhimin individual. Kjo, e autorizuar nga autoriteti apo organizmi inspektues (i kontrollit), të aplikohet për një periudhë kalimtare pesë vjecare.

6.1.6 Me kufizimet ligjore që vijnë më pas, gjedhët në ekonomitë e vogla mund të fiksohen (lidhen) nëse nuk është e mundur të mbahen gjedhët në grupe në përshtatje me kërkesat e mbarëvajtjes së tyre ose të paktën dy herë në javë të çohen në kullotë apo hapësira të lira të hapura. Ky veprim, i cili duhet të autorizohet nga autoriteti apo organizmi inspektues, aplikohet në ekonomitë që kënaqin (plotësojnë) kërkesat natyrale lidhur me prodhimin organik të kafshëve

6.1.7 Atje ku kafshët mbahen në grupe, madhësia e grupit duhet të varet nga faza e zhvillimit dhe nevojat e mirëqënies së specieve. Është e ndaluar mbajtja e kafshëve në kondicion apo nën një regjim të ushqyeri që mund të shkaktojë aneminë.

6.1.8 Mosha minimale për therjen e shpendëve është:
81 dite per pulat,
150 ditë për gjelat,
49 ditë për rosat Pekineze,
70 ditë për rosat Muscovy
84 ditë për rosakët Muscovy
92 ditë për rosa bastarde (shtegëtare)
94 ditë për pulat afrikane
140 ditë për gjelat e detit dhe patat
Kur prodhuesit nuk mund të aplikojnë moshat minimum të therjes, ata duhet të përdorin linja me rritje të ngadaltë.

6.2 Transporti

6.2.1 Transporti i kafshëve duhet të kryhet në mënyrë që të kufizojë stresin e vuajtur nga kafshët. Proçesi i ngarkimit dhe shkarkimit duhet të kryhet me kujdes dhe pa përdorimin e ndonjë tipi të stimulimit elektrik të kafshëve. Ndalohet përdorimi i qetësuesve allopatikë para dhe gjatë transportit.

6.2.2 Gjatë periudhës që sillet për tu therur dhe deri në therje kafsha duhet të trajtohet në mënyrë të tillë që të reduktohet në minimum stresi.

6.3 Identifikimi i produkteve blegtorale

6.3. 1 Kafshët dhe produktet blegtorale duhet të jenë të identifikuara gjatë gjithë fazave të prodhimit, pregatitjes, transportit dhe marketingut.

7. Mbeturinat organike (Plehu) të kafshëve

7.1 E tërë sasia e plehrave në total, e përdorur në një ekonomi nuk mund ti kalojë të 170 kg azot për vit/hektarë të përdorur në një zonë bujqësore. Nëse është e nevojshme, mund të reduktohet densiteti i kafshëve të stokuara për të shmangur mbingarkesën e kufizuar të shprehur më sipër.

7.2 Për të përcaktuar densitetin e përshtatshëm të kafshëve të referuar më sipër, njesitë e kafshëve ekuivalent me 170 kg azot për vit/ha të zonës bujqësore e përdorur për kategori të ndryshme kafshësh do tu referohen të dhënave të shprehura në shtojcën VII.

7.3 Ekonomitë që praktikojnë metodën e prodhimit biologjik mund të krijojnë bashkëpunim me ekonomi dhe ndërmarrje të tjera të cilat veprojnë në përputhje me parashikimet e kësaj shtojcë, me qëllim shpërndarjen e plehrave të tepërta nga prodhimi organik. Ky limit maksimum prej 170 kg azot nga plehrat organike për vit/ha nga zona bujqësore e përdorur, do llogaritet bazuar në të gjtha njesitë e prodhimit organik të përfshirë në një ko-operim të tillë.

7.3 Mjetet e destinuara për ruajtjen e plehrave organike të kafshëve duhet të jenë të një kapaciteti të tillë që të parandalojnë ndotjen e ujit nga shkarkimet direkte, ose nëpërmjet shkarkimeve dhe infiltrimeve të tokës.

7.4 Për të siguruar manaxhimin e saktë të plehrave, impiantet e ruajtjes së plehrave organike duhet të kenë një kapacitet ruajtje të caktuar për një periudhë të gjatë të vitit , në të cilën aplikimi

në tokë i plehrave nuk është oportun apo kur aplikimi i tillë ndalohet, në rastet ku njësia prodhuese vendoset brenda një zone e përcaktuar si e prekshme (e ekspozuar) ndaj nitrateve.

8. Zonat e lira për lëvizje dhe strehimi i kafshëve.

8.1 Parime të përgjithshme

8.1.1 Kushtet e strehimit per kafshët duhet të plotësojnë nevojat biologjike dhe etologjike (p.sh. nevojat e sjelljes që lidhen me lirinë e lëvizjes dhe komfortin). Kafshët duhet të kenë akses të plotë për ushqim dhe ujë. Izolimi, ngrohja dhe ventilimi i stallave duhet të sigurojë që qarkullimi i ajrit, niveli i pluhurave, temperatura, lagështia relative e ajrit dhe përqëndrimi i gazit, të mbahen brenda limiteve të cilat nuk janë të dëmshme për kafshët. Stallat duhet të lejojnë një ventilim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral.

8.2 Ruajtja e densitetit të kafshëve dhe mbrojtja e vegjetacionit nga mbikullotja

8.2. 1 Nuk është i detyrueshëm strehimi për kafshët në zonat me kushte të përshtatshme klimaterike të cilat lejojnë që kafshët të mund të jetojnë jashtë.

8.2.2 Densiteti i kafshëve nëpër stalla duhet të sigurojë komfortin e mirëqënien e kafshëve në funksion, në mënyrë të veçantë, të species, racës dhe moshës së kafshës. Githashtu duhet te llogariten dhe nevojat e lëvizjes së kafshëve, që varet në mënyrë të veçantë nga madhësia e grupit dhe e seksit të kafshëve. Densiteti optimum do të kërkojë të sigurojë mirëqënien e kafshëve duke ju siguruar atyre hapësirë të mjaftueshme për të qëndruar në mënyrë të natyrshme, të shtrihen lehtësisht, të rrotullohen, të pastrojnë vetveten, të ndërmarrin të gjitha pozicionet natyrale dhe të bëjnë të gjitha llojet e lëvizjeve të tilla si shtriqjet apo ndeshjet midis kafshëve.

8.2.3 Sipërfaqet minimale për strehimin e kafshëve dhe zonat jashtë tyre për lëvizjet e tyre (padoqet), dhe karakteristika të tjera të strehimit për specie dhe kategori të ndryshme kafshësh, janë paraqitur në shtojcën VIII.

8.2.4 Densiteti i kafshëve të mbajtura në kullotë, vende të tjera me bimësi, në toka mesatare, toka me lagështi, zona me shqopa dhe vendqëndrime natyrale apo gjysëm-natyrale, duhet të jetë mjaft i ulët për të parandaluar rrëshkitjen e tokës dhe konsumin e gjithë bimësisë.

8.2.5 Stallat, ndërtesa, rrethime, pajisje dhe aparaturat duhet të pastrohen dhe dezinfektohen mjaft mirë për të parandaluar kontaminimin dhe për të siguruar profilaksinë ndaj organizmave patogjenë. Vetëm produktet e listuara në Pjesën E të shtojcës II mund të përdoren për një pastrim dhe dezinfektim të tillë të stallave dhe impianteve zooteknike. Feçet, urina dhe ushqimet e pa ngrëna apo të ndotura duhet të hiqen sa më shpesh si një nevojë për të minimizuar erën e keqe dhe të shmanget tërheqja e insekteve apo rodentëve. Vetëm produktet e listuara në pjesën B, seksioni 2, te shtojcës II mund të përdoren për eleminimin e insekteve apo dëmtuesve të tjerë në ndërtesa (stalla) apo impjante të tjera ku mbahen kafshë.

8.3 Gjitarët

8.3.1 Të gjithë gjitarët duhet të kenë akses për në kullota, padoqe apo zona të hapura për lëvizjen e kafshëve të cilat mund të jenë pjesërisht të mbuluara dhe që kafshët të mund ti përdorin ato zona sipas kushteve fiziologjike të kafshëve, nëse e lejojnë kushtet dhe gjendja e tokës. Barngrënësit, duhet të kenë akses kurdoherë që e lejojnë kushtet.

8.3.2 Në rastet kur barëngrënësit kanë mundësi kullotjeje gjatë periudhës së kullotjes dhe ku sistemi i strehimit gjatë dimrit ju jep liri për të lëvizur kafshëve, duhet hequr dorë nga detyrimi për të siguruar lëvizjen në mjedise të hapura gjatë dimrit.

8.3.3 Demat mbi 1 vjeç duhet të çohen në kullotë, padoqe apo zona të tjera të hapura.

8.3.4 Në fazën përfundimtare të majmërisë gjedhët, derrat dhe dhentë për prodhim mishi mund të mbahen në stalla me kusht që kjo periudhë të mos e kalojë 1/5 e jetës së kafshës dhe në ndonjë rast një periudhë prej maksimumi 3 muaj.

8.3.5 Stallat duhet të kenë dysheme të sheshtë por jo të lëmuar (të rëshkitshëm).Të paktën gjysma e gjithë dyshemesë duhet të jetë solidë dhe jo me kostruksion rrjet.

8.3.6 Stalla duhet të jetë e përshtatshme, e pastër, me shtresë të thatë dhe sipërfaqe të mjaftueshme, që duhet të jetë një konstruksion solid i pa rrëshqitëshem. Ne zonën e pushimit. shtresa duhet të jetë kashtë ose tjetër material natyral i përshtatshëm. Shtresa mund të përmirësohet dhe pasurohet me ndonjë produkt mineral i autorizuar për përdorim si pleh në bujqësinë organike në përputhje me pjesën A të shtojcës II.

8.3.7 Ndalohet mbajtja e viçave në bokse individuale mbas moshës 1 javëshe.

8.3.8 Dosat mund të mbahen në grupe përveç atyre që janë në fazën e fundit te barsmërisë dhe gjatë periudhës së mëmëzimit (me gica në gji). Gicat nuk duhet të mbahen në -Flat decks- ose në bokse të përbashkëta. Padoqet duhet ti japin mundësi derrave të gryejnë dhe të lëvizin lirisht etj. Me qëllim që derrat të gryejnë mund të përdoren substanca të ndryshme.

8.4 Shpendet

8.4.1 Shpendët duhet të rriten në mjedise të hapura dhe nuk duhet të mbahen në kafaze.

8.4.2 Zogjtë duhet të pijnë ujë në ujra që rjedhin, pellgje apo afër liqeneve, kurdo herë që e lejojnë kushtet e motit me synim respektimin e kërkesave të mirëqënies së kafshëve apo kushteve higjenike.

8.4.3 Të gjitha llojet e ndërtesave për shpendët duhet të plotësojnë kushtet minimale si vijon:

- Më e pakta, 1/3 e ndërtesës duhet të jetë solide, jo e rëshqitshme apo konstruksion rrjetë dhe mbuluar me një material të tillë si kashtë, tallash rërë apo torfë;
- Në kafazet për pulat pjellëse, duhet të ketë një pjesë mjaft të madhe të dyshemesë për pulat dhe për të grumbulluar jashtëqitjet.
- Ato duhet të kenë këmbaleca druri në madhësinë dhe në numrin në përshtatje me madhësinë e grupit dhe të zogjve siç parashtrohet në shtojcën VIII;
- Ato duhet të kenë brima hyrje/dalje të një madhësie të përshtatshme për zogjtë, dhe këto të kenë të paktën 4 m^2 per lOOm^2 të sipërfaqes së nevojs hme për zogjtë.
- Çdo kafaz nuk duhet të përmbajë më shumë se:

4800 zogj
3000 pula pjellëse
5200 pula afrikane
4000 rosa Muscovy apo Pekini ose 3200 rosake Muscovy apo Pekini apo të vegjlit e tyre.
2500 Gjela, pata ose gjela deti;

- Sipërfqaja e përdorshme në total në strehimet e shpendëve për prodhimin e mishit në një njësi të vetme prodhimi nuk duhet ti kalojë të 1600 m^2

8.4.4 Në rastin e pulave prodhuese drita natyrale duhet të shtohet me mjete artificiale për të siguruar një maksimum prej 16 orësh ndriçim në ditë me një periudhë pushimi të pakthyeshme pa ndriçim artificial prej të paktën 8 orësh.

8.4.5 Pulat duhet të mbahen dhe të rriten në mjedise të hapura kurdoherë që e lejojnë kushtet e motit dhe sa herë që është e mundur. Kjo periudhë duhet të zërë të paktën 1/3 e jetës së tyre. Këto mjedise të hapura të jenë të mbuluara kryesisht me vegjetacion të siguruara me mjete mbrojtese, dhe t'ju lejojë kafshëve që të kenë lugje (enë) në numur të përshtatshëm për të pirë e për të ngrënë.

8.4.6 Për arsye shëndetsore, ndërtesa duhet të ketë boshllëqe të lira midis dy grupeve shpendësh të rritura. Ndërtesat dhe mjediset e tjera të pastrohen dhe dezinfektohen gjatë kësaj kohe. Përveç kësaj, kur rritja e çdo tufe shpendësh ka perfunduar, vendi ku u mbajtën shpendët do të lihet bosh për të lejuar rigjenerimin e vegjetacionit dhe për arsye shëndetsimi të saj. Këto kërkesa nuk do aplikohen për një numur të vogël shpendësh të cilat nuk mbahen në këto zona dhe të cilat mbahen të lira gjatë gjithë ditës.

8.5 Kufizime të përgjithshme në strehimin e kafshëve

8.5.1 Siç rrjedh dhe nga kërkesat e parashtruara në paragrafin 8.3.1, 8.4.2, 8.4.3 dhe 8.4.5 dhe densiteti i mbajtjes parashtrohet në shtojcën VIII, autoriteti kompetent mund të autorizojë kufizime nga kërkesat e këtyre paragrafeve dhe prej shtojcës VIII për një periudhë të përkohshme që perfundon në 31 Dhjetor 2010. Ky kufizim mund të aplikohet vetëm në ekonomitë blegtorale që kanë ndërtesa (strehime) të ndërtuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe për më tepër në rast se këto strehime veprojnë afërsisht në përputhje me rregullat e caktuara në këtë ligj dhe që kanë të bëjnë me prodhimin blegtoral organik.

8.5.2 Operatorët që përfitojnë nga ky kufizim do të prezantojë, për autoritetin kopetent, një plan që përmban marrëveshjet të cilat sigurojnë, në fund të kufizimit, përputhshmëri me parashikimet e këtij aneksi.

C. Bletaria dhe Produktet që merren prej saj

1. Parime të përgjithshme.

1.1 Bletaria është një aktivitet që kontribuon në mbrojtjen e mjedisit dhe bujqësisë dhe prodhimit pyjor nëpërmjet pllenimit që kryhet nga bletët.

1.2 Kualifikimi i produkteve të bletëve si produkte organike është e lidhur ngushtë me dy karakteristika të trajtimit të koshereve dhe të cilësisë së mjedisit. ky kualifikim varet gjithashtu nga kushtet e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes (magazinimit) të produkteve nga bletët.

1.3 Kur një operator mban disa njësi me bletë në të njëjtën zonë të gjitha njësitë duhet të veprojnë në përputhje me kërkesat e kësaj shtojce. Siç del nga ky parim, një operator mund të mbajë (mbarështojë) njësi duke mos vepruar në përputhje me këtë shtojcë, me kusht që të gjitha kërkesat e kësaj shtojce të plotësohen, me përjashtim të parashikimeve të parashtruara në paragrafin 4.2 për

vendosjen e parqeve të bletëve. Në atë rast, produkti nuk mund të shitet sipas metodave të prodhimit organik.

2. Periudha e konversionit

2. 1 Produktet e bletëve mund të shiten sipas metodës së prodhimit organik vetëm nëse kushtet e rregullave të tanishme janë respektuar për të paktën një vit. Gjatë periudhës së konversionit dylli të zëvëndësohet sipas kërkesave të shtruara në paragrafin 8.3.

3. Origjina e bleteve

3.1 Në zgjedhjen e racave duhet të llogaritet kapaciteti i kafshëve për tu adoptuar në kushtet e rajonit, vitaliteti i tyre si dhe rezistenca e tyre ndaj sëmundjeve. Preferencë t'ju jepet racave Europiane të bletëve mellifere dhe ekotipeve të tyre lokale.

3.2 Parqet e bletëve krijohen nga ndarja e kolonive ose përftohen nga tufa bletesh apo koshere nga njësi që veprojnë në përputhje me parashikimet e kësaj shtojce.

3.3 Si rrjedhim i parë, në varësi të aprovimit të mëparshëm nga autoriteti apo organizmi inspektues, parqet e bletëve që egzistojnë në njesitë prodhuese që nuk veprojnë sipas rregullave të kësaj shtojce, mund të konvertohen.

3.4 Si rrjedhim i dytë, nga tufat e bletëve kërkohet nga bletërritësit të mos prodhohet sipas kësaj shtojce gjatë një periudhe kalimtare dy vjecare në varësi të periudhës së konversionit.

3.5 Si rrjedhim i tretë, rindërtimi i parqeve të bletëve do të autorizohet nga autoriteti apo organizmi i kontrollit, në rastin e mortalitetit të lartë të kafshëve e shkaktuar nga rrethana shëndetsore apo katastrofike kur nuk janë disponibël parqet që veprojnë sipas kësaj shtojce, në varësi të periudhës së konversionit.

3.6 Si rrjedhim i i katërt, për rinovimin e parqeve me 10% në vit të mbretëreshave dhe të bletëve që nuk veprojnë në përputhje me këtë shtojcë mund të inkorporohen në njësitë e prodhimit organik ato mbretëresha dhe bletë të vendosura në koshere me fletë dylli që vijnë nga njësitë e prodhimit organik. Ndërkohë nuk aplikohet periudha e konversionit.

4. Vendosja e parqeve të bleteve

4.1 Autoriteti Kopetent në MBU duhet të percaktoje rajonet apo zonat ku nuk mund të praktikohet apikultura që ti përgjigjet kërkesave të kësaj shtojce. Një hartë ku të listohet vendosja e përshtatshme e koshereve siç parashikohet në shtojcën III, Pjesa A1, seksioni 2 do sigurohet për autoritetin apo organizmin inspektues nga bletërritësit. Kur zona të tilla nuk identifikohen, bletërritesit duhet të sigurojnë autoritetin apo organizmin inspektues me një dokument dhe evidencë të përshtatshme, që përmban një analizë të përshtatshme nëse është e nevojshme, për të demostruar që zonat ku mbahen kolonitë e tij plotësojnë kushtet e kërkuara në këtë shtojcë.

4.2 Vendosja e parqeve duhet të jetë e tillë që:
(a) të sigurojnë mjaft nektar natyral, menja (mjalt i prodhuar nga kosumi i parazitëve), dhe burime poleni për bletët dhe ujë të mjaftueshëm;

(b) e tillë të jetë brenda një rrezeje prej 3 km nga vendosja e parkut, burimet e nektarit dhe polenit konsistojnë kryesisht në bimët e prodhuara në mënyrë organike dhe/ose bimësinë spontane, sipas kërkesave të Nenit 6 dhe Aneksit I të kësaj shtojcë.

(c) të ruajë distancë të mjaftueshme nga burimet e prodhimit bujqësor që mund të çojnë lehtësisht në ndotjen, p.sh: qendrat urbane, rrugët, zonat industriale, vendet ku trajtohen plehrat, etj. Autoritetet apo organizmat inspektues do të krijojnë masa për të siguruar këtë kërkesë.

Kërkesat e mësipërme nuk aplikohen në zonat ku nuk ka lulëzim ose kur kosheret jan1 inaktive (periudhën letargjike).

5. Ushqimi

5.1 Në fund të sezonit prodhues kosheret duhet të lihen me rezerva mjalti dhe poleni të mjaftueshëm për të mbijetuar gjatë periudhës së dimrit.

5.2 Ushqyerja artificiale e kolonive autorizohet kur mbijetesa e koshereve rrezikohet nga kushtet ekstreme të klimës. Të ushqyerit artificial do bëhet me mjaltë të prodhuar në mënyrë organike, e preferueshme është ajo nga e të njëjtës njësi prodhimi organik.

5.3 Si rrjedhim i parë i paragrafit 5.2, autoriteti kompetent mund të autorizojë përdorimin e shurupit të sheqerit të prodhuar në mënyrë organike, ose melasa e sheqerit organik në vend të mjaltit të prodhuar organikisht me ushqim artificial, në mënyrë të veçantë kur kërkohet nga kushtet klimatike dhe provokohet kristalizimi i mjaltit.

5.4 Si rrjedhim i dytë , shurupi i sheqerit, melasa e sheqerit dhe mjalti që nuk mbulohen nga kjo rregullore mund të autorizohet nga autoriteti apo organizmi i inspektimit për ushqimin atrificial gjatë një periudhë kalimtare dy vjecare.

5.5 Informacioni i mëposhtëm do të hyjë në rregjistrat e parkut të bletëve lidhur me përdorimin e ushqimit artificial, tipin e produktit, datën, sasinë dhe kosheret ku është përdorur.

5 .6 Produktet e tjera të ndryshme nga ato të paraqitura në paragrafet 5.1 deri 5.4 nuk mund të përdoren në bletari të cilat veprojnë në përputhje me këtë shtojcë.

5.7 Ushqimi artificial mund të përdoret vetëm ndërmjet periudhës së vjeljes së fundit të mjaltit dhe 15 ditë para se të filloje grumbullimi i nektarit të ri.

6. Parandalimi i semundjeve dhe trajtimet veterinare.

6.1 Parandalimi i sëmundjeve në bletari duhet të bazohet në parimet e mëposhtme:
(a) seleksionimi i racave të përshtatshme rezistente.
(b) aplikimi i praktikave të caktuara që inkurajojnë rezistencë të fuqishme ndaj sëmundjeve dhe parandalojnë infeksione, të tilla si: zëvëndësimi i regullt i mëmave (mbretereshave), kontroll sistematik i koshereve për të zbuluar ndonjë anomali shëndetësore, kontrolli i numrit të meshkujve në koshere, dezinfektimi i materialeve dhe pajisjeve në mënyrë periodikë, shkatërrimi i materialeve apo burimeve kontaminuese, ripërtëritja e rregullt e fletëve të dyllit dhe rezerva të mjaftueshme të polenit dhe mjaltit në koshere.

6.2 Nëse pavarësisht prej të gjitha masave parandaluese të mësipërme, kolonitë sëmuren ose infestohen, ato duhet të trajtohen në mënyrë të menjëhershme dhe nëse është e nevojshme kolonitë duhet të vendosen në parqe të izoluara.

6.3 Përdorimi i medikamenteve veterinare në bletari të cilat veprojnë sipas kësaj shtojcë që vepron sipas parimeve të mëposhtme:
(a) ato mund të përdoren përkohësisht në përputhje me përdorimin e autorizuar nga Autoriteti Kopetent.

(b) përdorimi i produkteve fitoterapike dhe homeopatike duhet të ketë përparësi ndaj produkteve allopatike të sintetizuara kimikisht, të cilat sigurojnë efekte terapeutike efektive në kushte në të cilat tentohet ky trajtim.

(c) Nëse përdorimi i produkteve të mësipërme do të provojë ose në të kundërt nuk do provojë se janë efektive për të çrrënjosur një sëmundje apo infeksion i cili rezikon shkatërrimin e kolonive, medikamentet allopatike të sintetizuara kimikisht mund të përdoren nën përgjegjësinë e veterinerit, apo personave të tjerë të autorizuar nga MBU, pa paragjykimin për parimet e paraqitura në paragrafët e mësipërme (a) dhe (b).

(d) Ndalohet përdorimi i medikamenteve allopatike kimikisht të sintetizuar për profilaksi.

(e) duke ruajtur parimin në 6.3. a. acidi formik, acidi laktik, acetik dhe oksalik dhe substancat e mëposhtme: mentol, timol, eukaliptol apo kamfor mund të përdoren në rastet e infestimit me Varroa jakobsoni.

6.4 Përveç parimeve të mësipërme, do të autorizohen trajtimet veterinare apo trajtimet e koshereve, fletëve të dyllit etj.., të cilat janë në përputhje me legjislacionin Kombëtar apo Komunitar.

6.5 Nëse një trajtim i aplikuar me produkte allopatike të sintetizuara kimikisht, gjatë një periudhe të tillë, kolonitë e trajtuara duhet të vendosen në parqe të izoluara dhe i gjithe dylli duhet të zëvëndësohet me dyll sipas kushteve të vendosura në këtë shtojcë. Për pasojë, periudha e konversionit e një viti do aplikohet në ato koloni.

6.6 Kërkesat e paraqitura në paragrafet e mëparshme nuk aplikohen në produktet e permendura në paragrafin 6.3(e)

6.7 Kurdoherë që përdoren produktet mjekësore veterinare, është e domosdoshme të deklarohet, tipi i produktit (përfshi tregimin e substancave aktive farmakologjike aktive) së bashku me detaje mbi diagnozen, përmbajtja, mënyra e përdorimit, zgjatja e trajtimit dhe periudhës e rekomanduar ligjërisht, duhet të jenë të rregjistruar dhe deklaruar mjaft qartë për autoritetin apo organizmin inspektues përpara se produktet të tregëtohen si të prodhuara organikisht.

7. Praktikat e mbarështimit zooteknik dhe identifikimi.

7.1 Ndalohet shkatërrimi i bletëve në f1etët e dyllit si metodë që shoqëron proçesin e grumbullimit të produkteve të bletarisë.

7.2 Ndalohet dëmtimi (thërmimi) i krahëve të mëmave (mbretëreshave)

7.3 Lejohet zëvëndesimi i mbretëreshës nëpërmjet vrasjes së mëmës së vjetër.

7.4 Lejohet praktika e shkatërrimit të tufës së meshkujve vetëm për të ruajtur (mbajtur) infestimin nga Varroa jacobsoni.

7.5 Ndalohet përdorimi i kimikateve sintetike me erë të keqe gjatë operacionit të vjeljes së mjaltit.

7.6 Zona ku është vendosur parku duhet të rregjistrohet së bashku me identifikimin e koshereve. Duhen të informohen autoriteti ose organi i kontrollit për levizjen e parkut brenda një kohe sipas një marrveshjeje me autoritetin ose organin e kontrollit.

7.7 Kujdes i veçantë duhet të tregohet për të siguruar vjelje të përshtatshme, përpunim si dhe ruajtjen e prdhimeve të bletarisë. Të gjitha masat që veprojnë në përputhje me keto kërkesa do të regjistrohen.

7.8 Heqja e hojeve dhe veprimet e vjeljes së mjaltit të regjistrohen në regjistrin e parkut.

8. Karakteristikat e koshereve dhe materialet e përdorura në bletari

8. 1 Kosheret të ndërtohen detyrimisht nga materiale natyrale që nuk paraqesin reziqe të kontaminimit të ambjentit apo prodhimet e bletarisë.

8.2 Me përjashtim të produkteve të përmendura në paragrafin 6.3 (e) në koshere mund të përdoren vetëm produkte naturale si propolis, dyll dhe vajra bimore.

8.3 Dylli i bletës për të bërë fletët e reja të dyllit duhet të vijnë nga njësitë e prodhimit organik. Në kuadër të kufizimeve, në mënyrë të veçantë në rastin e impjanteve të reja apo gjatë periudhës së konversionit, dylli i zakonshëm mund të autorizohet nga autoritetet dhe organet e kontrollit në rrethana të jashtëzakonshme aty ku nuk ka dyll të prodhuar në mënyrë organike në treg dhe me kusht që te vijë nga pjesa e sipërme e kosheres.

8.4 Ndalohet përdorimi i fletëve të dyllit të cilat përmbajnë bletë, larva, meshkuj etj, gjatë kohës së grumbullimit të mjaltit.

8.5 Për mbrojtjen e materialeve (korniza, koshere dhe hojet e dyllit), në mënyrë të veçante nga dëmtuesit, lejohen vetëm produktet e përshtatshme të listuara në pjesën B, Seksioni 2, i shtojcës II.

8.6 Lejohen trajtimet fizike si avull apo f1aka direkte.

8.7 Për pastrimin dhe dezinfektimin e materialeve, ndërtesave, pajisjeve, aparatura apo produktet e përdorura në bletari lejohen të përdoren vetëm substancat e listuara në anksin II Pjesa E.

ANEKSI II

A. PLEHRAT DHE PASURUESIT E TOKËS

Kushtet e përgjithshme për të gjitha produktet:

- përdoren vetëm në përputhje me vendimet e Shtojcës A,
- përdoret vetem në përputhje me vendimet e legjislacionit për daljen në treg dhe përdorimin e produkteve në fjalë të zbatueshme në bujqësinë e përgjithshme të Shtetit ku produkti është përdorur.

Emri	***Përshkrimi, kërkesat për përbërjen, kushtet e përdorimit***
Produkte të përbëra ose produkte që përmbajnë vetëm materiale të listuara më poshtë	
Plehu i fermës	Produkt që përmban një përzjerje të jashtëqitjeve të kafshëve dhe lëndëve bimore (shtrati i kafshëve). Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues. Të dhëna për speciet e kafshëve. I ardhur nga nje ekonomi e gjerë
Pleh i fermës i tharë dhe. plehu i shpendëve i dehidratuar	Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues Të dhëna për speciet e kafshëve. I ardhur nga nje ekonomi e gjerë
Jashtëqitjet e përbëra të kafshëve, duke përfshirë plehun e shpendëve dhe. plehun e përbërë të fermës	Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues. Të dhëna për speciet e kafshëve Të ndaluara nqs vijnë nga rritje industriale.
Jashtëqitjet e lëngëshme të kafshëve	Përdoret pas fermentimit të kontrolluar dhe /ose hollimit të përshtatshëm. Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues. Të dhëna për speciet e kafshëve. Të ndaluara nqs kane origjinë nga rritje industriale.
Mbeturina shtëpiake të përbëra ose të fermentuara	Produkte të fituara nga mbeturinat shtëpiake të ndara sipas origjinës, të cilat i janë nënshtruar përzjerjes ose fermentimit anaerobik për prodhimin e biogazit. Vetëm mbeturina bimore dhe shtazore Vetëm kur prodhohen nga një sistem grumbullimi të mbyllur dhe të monitoruar, të pranuar nga Shteti Anëtar.

	Maksimumi i përqëndrimeve në mg/kg në lënde të thatë: kadmium: 0.7; bakër: 70; nikel: 25; plumb: 45; zink: 200; merkur: 0.4; krom (i përgjithshëm): 70; krom (VI): 0 (*). Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.
Turbe	Përdorim i kufizuar në ortikulture (floriculturë, arboriculture, fidanishte)
Argjilat (psh. Perlite, vermiculite etj.)	
Mbetejet e kërpudhave	Përbërja fillestare e substratit duhet të jetë e kufizuar në produktet e listës aktuale.
Jashtëqitjet e krimbave (paraziteve) dhe insekteve	
Guano	Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.
Materiale bimore të përzjera ose fermentuara	Produkte të fituara nga përzjerja e materialeve bimore, të cilat i janë nënshtruar përzjerjes ose fermentimit anaerobik për prodhimin e biogazit. Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.
Produkte ose nënprodukte me origjinë shtazore, si më poshtë: - miell gjaku - miell thundrash - miell brirësh - miell kockash - miell peshku - miell mishi - miell puplash, - f1okësh - leshi - gëzofi - f1oke - produkte bulmeti	Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues. Maksimumi i përqëndrimit në mg/kg të lëndës së thatë të kromit (VI): Maksimumi i përqëndrimit në mg/kg të lëndës së thatë të kromit (VI):
Produkte dhe nënprodukte me origjinë bimore për plehra (psh miell farash vajore, lëvozhga kakaos, mbeshtjellja maltit etj.)	
Leshterikët dhe produktet me bazë leshteriku	Të fituara direkt nga: (i) përpunime fizike që përfshijnë dehidratimin, ngrirjen dhe coptimin; (ii) ekstraktim me tretesirë ujore ose acide dhe/ose tretësirë bazike; (iii) fermentimi Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.
Pluhur sharre dhe tallash druri	Dru i patrajtuar kimikisht pas prerjes
Levore druri e përbërë	Dru i patrajtuar kimikisht pas prerjes
Hi druri	Nga dru i patrajtuar kimikisht pas prerjes

Shkëmbinj të butë me bazë fosfate	Përmbajtje e kadmiumit më e vogël ose e barabartë me 90 mg/kg P_20_5.
Fosfat alumin-kalcium	Përrnbajtje e kadmiumit më e vogel ose e barabartë me 90 mg/kg P_20_5. Përdorimi i kufizuar i tokave bazike (H> 7.5)
Skorjet bazike	Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.
Kripë kaliumi e papërpunuar (psh kainit, silvinit etj.)	Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues
Sulfat kaliumi, mundësisht të përmbaj kripë magnezi	Produkt i fituar nga kripa e kadmiumit e papërpunuar me proces ekstraktimi fizik, dhe gjithashtu të përmbaj mundësisht kripra magnezi; Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues
Karbonat kalciumi me origjinë natyrale (psh shkumës, gurë gëlqeror, shkumës fosfatik etj.)	
Karbonat magnezi dhe. kalciumi me origjinë natyrale (psh shkumës magnezik, gurë gëlqeror magnezi etj.)	Vetëm me origjinë natyrale Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.
Sulfat magnezi (psh kieserite)	
Tretësirë klorur kalciumi	Trajtues i gjetheve të pemës së mollës, pas identifikimit të mangësisë së kalciumit. Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.
Sulfat kalciumi (gips)	vetem me origjinë natyrale.
Gëlqere industriale nga prodhimi i sheqerit	Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.
Squfuri elementar	Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.
Elementët gjurmë	Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.
Klorur kaliumi	Vetëm kripë guri
Miell guri	Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.

B. **PESTICIDET**

1.Produktet për mbrojtjen e bimëve

Kushtet e përgjithshme të zbatueshme për të gjitha produktet e përbëra ose që përmbajnë substancat aktive të mëposhtëme:

- përdoren në përputhje me vendimet e Shtojcës I,

- vetëm në përputhje me vendimet specifike të legjislacionit të produkteve të mbrojtjes së bimëve i zbatueshëm në Shtetin Anëtar ku produkti është përdorur.

I.Substancat me origjinë bimore ose shtazore

Emri	***Përshkrimi, kërkesat për përberjen, kushtet e përdorimit***
Azadiraktina e ekstraktuar nga *Azadirachta indica*	Insekticide Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.
Dyllë blete	Agjent krasitës
Xhelatinë	Insekticide
Proteina të hidrolizuara	Atraktues Vetëm në aplikime të autorizuara e kombinuar me produkte të tjera të përshtatëshme të Shtojcës II, Pjesa B.
Lecitina	Fungicid
Ekstrakte nga *Nicotiana tabacum* (tretësirë ujore)	Insekticid Vetëm kundër morrave në pemët e frutave subtropikale (psh portokalle, limon) dhe frutave tropikale (psh banane) Përdoret vetëm në fillim për bimët tropikale. Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.
Vajra bimore (psh vaj mente, vaj pishe, vaj qimioni)	Insekticid, acaricide, fungicide dhe ngadalsues i mbirjes.
Piretrin ekstraktuar nga *Chrysanthemum cinerariaefolium*	Insekticid Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues
Kuasia ekstraktuar nga *Quassia amara*	Insekticid, neveritës (jo atraktues)
Rotenone ekstraktuar nga *Derris spp.* dhe *Lonchocarpus spp.* dhe *Terphrosia spp.*	Insekticid Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.

II. Mikro-organizmat e përdorura për kontrollin biologjik të dëmtuesve

Emri	***Përshkrimi, kërkesat për përbërjen, kushtet e përdorimit***
Mikro-organizmat (bakterie, viruse dhe kërpudha) psh *Bacillus thuringiensis*, *Granulose virus* etj.	Vetëm produkte të pamodifikuara gjenetikisht.

III. Substancat e përdorura në kurthe dhe/ose shpërndarje

Kushtet e përgjithshme:

- Kurthet dhe/ose shpërndarjet mund të parandalojnë penetrimin e substancave në mjedis dhe ndalojnë kontaktin e substancave me bimët e kultivuara
- Kurthet duhet të mblidhen pas përdorimit dhe të mbahen në vende të sigurta.

Emri	***Përshkrimi, kërkesat për përbërjen, kushtet e përdorimit***
Fosfat diamoni	Atraktues Vetëm në kurthe
Metaldehid	Moluskicid Vetëm në kurthe që përmbajnë neveritës për speciet e kafshëve te mëdha.
Feromonet	Atraktues; me sjellje shkatërruese seksuale Vetëm në kurthet dhe shpërndarësit.
Piretroidet (vetëm deltametrin ose lambdaksihalotrin)	Insekticid Vetëm në kurthe me atraktues specifik Vetëm kundër *Batrocera oleae* dhe *Ceratitis capitata* Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues

IV. Substanca të tjera të përdorimit tradicional në bujqësinë organike

Emri	***Përshkrimi, kërkesat për përbërjen, kushtet e përdorimit***
Bakër në formën e hidroksidit të bakrit, oksiklorurit të bakrit, sulfat bakri (tribazik), oksid bakri	Fungicide Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues
Etilen	Për ruajtjen e ngjyrës së bananes
Kripë kaliumi i acideve yndyrore (sapun i bute)	Insekticid
Kalinite	Parandalues i pjekjes së bananes
Polisulfit kalciumi	Fungicid, insekticid, akaricid; Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues
Vaj parafine	Insekticid, akaricid
Vajra minerale	Insekticide, fungicide Vetëm në pemët frutore, vreshta, ullinj dhe bimë tropikale (psh banane);
	Nevoja e njohjes nga autoriteti ose organizmi inspektues.
Permanganat kaliumi	Fungicide, baktericide; Vetëm në pemët frutore, ullinj dhe vreshta.
Rërë kuarcore	Neveritës
Squfur	Fungicid, akaricid, neveritës

2. Produkte për kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve në stalla dhe impiante:

Produkte të listuara në Seksionin 1.
Rodenticidet.

C. USHQIMI I KAFSHËVE

1 .Materialet ushqyese me origjinë bimore.

1.1. Drithërat, produktet dhe nënproduktet e tyre. Në këtë kategori janë përfshirë substancat e mëposhtëme:

Tërshërë si kokërr, tufe, lëvore dhe krunde;
Elbi si kokërr, protein dhe miell mesatar dhe krunde;
Orizi si kokërr, oriz i thyer, krunde dhe embrion; meli si kokërr;
Thekër si kokërr, middlings dhe krunde;
Sorghum si kokërr;
Gruri si kokërr, middlings, krunde, ushqim glutenoz, gluten dhe embrion;
drithëraTriticale si kokërr;
Misër si kokërr, krunde, middlings, embrion dhe gluten;
Malt

1.2. Farat vajore, frutat vajore, produktet dhe nënproduktet e tyre. Në këtë kategori janë përfshirë substancat e mëposhtëme:
fara të pjekura, embrioni dhe cipa;
farat e sojës si farë, e pjekur, embrioni dhe cipa;
fara e luledielli si farë dhe embrion;
pambuku si farë dhe embrion farë;
fara lirit si farë dhe embrion;
kokrra palmës si embrion;
farat e pjekura të rrepës së bardhë si embrion dhe lëvore;
farat e kungullit të pjekura;
pulpa ullirit (nga ekstraksioni fizik i ullinjve);

1.3. Farat leguminoze, produktet dhe nënproduktet e tyre. Në këtë kategori janë përfshirë substancat e mëposhtëme:

bizele si fare;
buxhak si farë e marrë nga një trajtim i përshtatshëm me nxehtësi;

bizele si farë, middlings dhe krunde;
batha si farë, middlings dhe krunde;
lupini si farë.

1. 4. Zhardhokët rrënjorë, produktet dhe nënproduktet e tyre. Në këtë kategori janë përfshirë substancat e mëposhtëme:

pulpa e panxhar sheqerit,
panxhar i tharë,
patate,
patate e ëmbël,
maniok si rrënjë,
pulpa patates (nënprodukt i ekstraktimit të niseshtesë së patates),
niseshteja e patates,
proteina patates.

1.5. Fara dhe fruta të tjera, produktet dhe nënproduktet e tyre. Në këtë kategori janë përfshirë substancat e mëposhtëme:

pulpa e agrumeve,
pulpa e mollës,
pulpa e domates,
pulpa e rrushit.

1. 6. Foragjeret dhe forazhet e trasha. Në këtë kategori janë perfshirë substancat e mëposhtëme:

jonxhë
miell jonxhe,
tërfil,
miell tërfili,
bari (marrë nga bimët foragjere),
miell bari,
san,
silazh,
kashtë drithërash,
rrënjë bimësh për foragjere.

1. 7. Bimë të tjera, produktet dhe nënproduktet e tyre. Në këtë kategori janë përfshirë substancat e mëposhtëme:

melasa si agjent lidhës në ushqimet e përbëra me miell aglash (marrë nga tharja dhe shtypja e aglave dhe të lara për të reduktuar përmbajtjen e jodit), pluhurat dhe ekstraktet e bimëve, ekstrakti i proteinave bimore (për kafshët e reja), erëzat dhe aromat.

2. USHQIMI PËR KAFSHË ME ORIGJINË SHTAZORE

2.1. Qumështi dhe nënproduktet e tij. Në këtë kategori janë përfshirë substancat e mëposhtëme:

Qumësht i freskët, qumësht pluhur, qumësht i skremuar, qumësht i skremuar pluhur, gjalp, gjalp pluhur, hirrë, hirrë pluhur, hirrë pluhur me pak sheqer, proteinat e hirrës pluhur (ekstraktuar me trajtim fizik), kazein pluhur dhe laktozë pluhur.

2.2. Peshk dhe kafshë të tjera deti, produktet dhe nënproduktet e tyre. Në këtë kategori janë përfshirë substancat e mëposhtëme:
peshk, vaj peshku dhe vaj i parafinuar i mëlçisë së merlucit;
peshk moluskan, hidrolizate dhe proteolizate të marra nga veprimi i një enzime, në formë të tretëshme ose jo, miell peshku.

3. USHQIMI PËR KAFSHË ME ORIGJINË MINERALE.

Në këtë kategori janë përfshirë substancat e mëposhtëme:

Natriumi:
kripë deti e parafinuar, kripë guri e papërpunuar, sulfat natriumi, karbonat natriumi, bikarbonat natriumi, klorur natriumi.

Kalcium:
Guackat e kafshëve ujore (përfshirë kockat e sepieve),
Karbonat kalciumi,
Laktat kalciumi,
glukonat kalciumi.

Fosfori:
precipitati i fosfatit bikalcik i kockave, fosfat bikalcik i defluonnuar.
Squfuri:
sulfat natriumi

D. SHTESAT USHQIMORE NË USHQIMIN PËR KAFSHË, SUBSTANCA TË CAKTUARA TË PËRDORURA NË USHQYERJEN E KAFSHËVE DHE LËNDËT NDIHMËSE TË PËRPUNIMIT TË PËRDORURA NË USHQIMET E KAFSHËVE

1.SHTESAT USHQIMORE NË USHQIMIN PËR KAFSHË

1. *1. Elementet gjurmë.* Në këtë kategori janë përfshirë substancat e mëposhtëme:

E1	Hekuri: karbonat hekuri (II) sulfat hekuri (II) monohidrat oksid ferric (III)
E2	Jodi: Jodur kalciumi, anhider Jodur kalciumi, hekzahidrat Jodur lakciumi

E3	Kobalt: sulfat kobalti (II), monohidrat dhe/ose heptahidrat karbonati bazik i kobaltit (II), monohidrat
E4	Baker: oksid bakri (II) karbonati bazik I bakrit (II), monohidrat sulfati bakrit (mono dhe/ose tetrahidrat
E5	Mangani: karbonat mangani (II) oksid mangani dhe oksid manganik sulfat mangani (II), mono dhe/ose tetrahidrat)
E6	Zink: karbonat zinku oksid zinku sulfat zinku, mono dhe/ose tetrahidrat
E7	Molibden: molibdat amoni, molibdat natriumi
E8	Seleni: selenat natriumi selenit natriumi

1.2. Vitaminat, provitaminat dhe substancat e përcaktuara mirë kimikisht që kanë efekt të ngjashëm. Në këtë kategori janë përfshirë substancat e mëposhtëme:

-të preferueshme marrë nga lëndë të para që ndodhen në mënyrë natyrale në ushqimin për kafshë,
-vitaminat sintetike identike me vitaminat natyrale vetëm për kafshët monogastrite.

1.3. *Enzimat.*
1.4. *Mikroorganizmat.*
1.5. *Konservantët.* Në këtë kategori janë përfshirë substancat e mëposhtëme:

E 236	Acidi formik vetëm për silazhe
E 260	Acidi acetik vetëm për silazhe
E 270	Acidi laktik vetëm për silazhe
E 280	Acidi propionik vetëm për silazhe

1 .6. Agjentët lidhës, antiglomerantët dhe koaguluesit. Në këtë kategori janë përfshirë substancat e mëposhtëme:

E551b	Silice koloidale
E551c	Kiselgur
E 553	Sepiolit
E558	Bentonit
E 559	Argjili kaolinitike
E 561	Vermikulite
E 599	Perlite

2. Produkte të caktuara të përdorura në ushqyerjen e kafshëve.

Në këtë kategori janë përfshirë produktet e mëposhtëme:

2.1. Lëndët ndihmëse të përpunimin për silazh. Në këtë kategori janë përfshirë produktet e mëposhtëme:
kripa e detit, kripa e gurit e papërpunuar, enzimat, majatë, hirra, sheqeri, pulpa e panxhar sheqerit, mielli i grurit, melasa dhe bakteriet laktike, acetike, formike dhe propionike.
Kur kushtet e motit nuk lejojnë fermentimin e duhur, autoriteti ose organizmi inspektues mund të autorizoj përdorimin e acideve laktik, formik, propionik dhe acetik për prodhimin e silazhit.

E. PRODUKTET E AUTORIZUARA PËR PASTRIMIN DHE DISIFEKTIMIN E STALLAVE DHE IMPIANTEVE(P.SH. PAJISJE DHE ENË)

Sapun kaliumi dhe natriumi
Ujë dhe avull
Qumësht gelqere
Gëlqere
Gëlqere e pashuar
Hipoklorit natriumi (p.sh. si lëng zbardhues)
Soda kaustike
Potas kaustik
Peroksid hidrogjeni
Esenca natyrale të bimeve
Acid citrik, peracetik, formik, laktik, oksalik dhe acetik
Alkool
Acid nitrik (për pajisjet e bulmetit)
Acid fosforik (për pajisjet e bulmetit)
Formaldehid
Produkte për pastrim dhe desifektim për pajisjet e qumështit
Karbonat natriumi.

F. PRODUKTE TË TJERA

ANEKSI III

KËRKESAT MINIMALE TË INSPEKTIMIT DHE MASAT PARAPRAKE TË RREGJIMIT TË INSPEKTIMIT.

A.1. Bimët ose produktet bimore të marra nga prodhimet bujqësore ose të mbledhura.

1. Prodhimi duhet të bëhet në një njësi të ngastrave të tokës dhe prodhimi dhe ruajtja të jenë të ndara qartë nga ato të ndonjë njësie tjetër që nuk prodhon në përputhje me rregullat e vendosura në këtë ligj; raportet e përpunimit dhe/ose paketimit mund të jenë pjesë e njësise, kur aktiviteti i tyre është i kufizuar në përpunimin dhe paketimin e produktit te tij bujqësor.

2. Kur rregullat e inspektimit zbatohen për herë të parë, edhe pse aktiviteti i prodhuesit është kufizuar në mbledhjen e bimëve të egra, organizmi inspektues duhet të përshkruaj:

- një përshkrim të plotë të njësisë, duke treguar ambjentet e ruajtjes dhe përpunimit dhe ngastrat e tokës dhe/ose zonat e mbledhjes dhe, kur është e zbatueshme, ambientet ku kryhen operacione të caktuara të përpunimit dhe/ose paketimit,

- të gjitha masat praktike të marra nga prodhuesi në nivel njësie për të siguruar plotësimin e vendimeve të këtij ligji

- Dhe, në rastin e mbledhjes së bimëve të egra, jepet garanci palëve të treta, që prodhuesit mund të provojnë se janë plotësuar vendimet e Shtojcës I, pika 4.

Përshkrimi dhe masat e dhëna duhet të përmbahen në një raport inspektimi të firmosur nga prodhuesi i interesuar. Për më tepër, raporti duhet të specifikoj:

- datën e aplikimit të fundit në ngastra dhe/ose zonat e mbledhjes të produkteve përdorirni i të cilave nuk është në përputhje me këtë ligj

3.Çdo vit, përpara datës së caktuar nga organizmi inspektues, prodhuesi duhet t'i njoftoj organizmit skedën e tij të prodhimit të produkteve bimore, duke dhënë një përshkrim analitik për çdo ngastër.

4.Duhet të mbahet rregjistër i shkruar dhe/ose dokumentuar i cili do të lejoj organizmin e inspektimit të identifikoj origjinën, natyrën dhe sasinë e të gjithë lëndëve të para të blera, dhe përdorimin e materialeve të tilla; për më tepër, duhet të mbahen rregjistra të shkruara ose dokumentuara për natyrën, sasitë dhe destinacionin e të gjithë produkteve bujqësore të shitura. Sasitë e shitura direkt tek konsumatori i fundit do të llogariten në bazë ditore. Kur njësia përpunon produktet e veta bujqësore, në rregjistër duhet të mbahet informacion sipas pikës B, 2, pjesa e tretë e kësaj Shtojcë.

5.Ndalohet magazinimi në njësi e lëndëve të para të ndryshme nga ato të përdorura në përputhje me këtë ligj

6.Përveç vizitave inspektuese të paralajmëruara, organizmi inspektues duhet të bëj inspektim të plotë fizik të njësisë, të paktën njëherë në vit.

Pas çdo vizite hartohet një raport inspektimi, i cili firmoset edhe nga personi përgjegjës i njësisë.

7.Prodhuesi duhet ti japë organizmit inspektues, për qëllime inspektimi, akses në ambjentet e magazinimit dhe prodhimit dhe në ngastrat e tokës, gjithashtu në llogaritë dhe dokumentat e tjera mbështetëse. Ai duhet ti sigurojë organizmit inspektues çdo informacion të domosdoshëm për qëllime inspektimi.

8.1. Produktet mund të transportohen në njësitë e tjera, duke përfshirë tregëtinë me shumicë dhe pakicë vetëm në ambalazhe të përshtatshme ose në kontenier të mbyllur në mënyrë për të ndaluar zëvëndësimin e përmbajtjes dhe të siguruar me etiketë, pa paragjykuar çdo tregues tjetër të kërkuar nga ligji:

(a) emrin dhe adresën e personit përgjegjës për prodhimin ose përgatitjen e produktit, ose, kur është përmendur një shitës tjetër, një deklarim i cili lejon njësinë dhe organizmin inspektues të identifikojë pa ekuivoke personin pergjegjës për prodhimin e produktit;

(b) emrin e produktit, duke përfshirë një referencë të metodës së prodhimit organik,.

8.2. Megjithatë, mbyllja në ambalazhim ose kontenier nuk kërkohet kur:

(a) transportimi është midis një prodhuesi dhe një operatori tjetër të cilët që të dy i nënshtrohen sistemit të inspektimit dhe

(b) produktet janë shoqëruar nga një dokument ku jepet informacioni i kërkuar sipas nënparagrafit të mëparshëm.

9. Kur një operator ka disa njësi prodhimi në të njëjtën zone që prodhojnë bimë ose produkte bimore të pambuluara nga Neni 1 sëbashku me ambientet e magazinimit të lëndëve të para (të tilla si plehra, insekticide, fara) duhet ti nënshtrohen rregullave të inspektimit në përputhje me nënparagrafin e parë të pikës 2 dhe pikave 3 dhe 4. Bimët e të njëjtit varietet si ato të prodhuara në njësinë e treguar në pikën 1 nuk mund të prodhohen në këto njësi, megjithatë, prodhuesit mund të shmangen nga rregulli i dhënë në fjalinë e fundit të nënparagrafit të mëparshëm:

(a) në rastin e prodhimit të produkteve bujqësore shumëvjeçare (pemë frutore, hardhi dhe lupuli) me kusht që të plotësojnë konditat:

1. prodhimi në fjalë bën pjesë në një plan transformimi në lidhje me të cilën prodhuesi impenjohet dhe siguron për fillimin e transformimit të pjesës së fundit të zonës së interesuar për prodhim organik në periudhën me të shkurtër të mundëshme e cila nuk mundet në asnjë rast të kaloj maksimumin prej 5 vjetësh.

2. Duhet të merren masa të përshtatëshme për të siguruar një ndarje të përherëshme të produkteve të marra nga secila njësi e interesuar.

3. Organizmi ose autoriteti inspektues duhet të njoftohet për vjeljen e secilit produkt të paktën 48 orë përpara.
4. Menjëherë pas përfundimit të vjeljes, prodhuesit informojnë organizmin ose autoritetin inspektues për sasinë e saktë të vjelur në njësitë e interesuara sëbashku me çdo veti të veçantë dalluese (të tilla si cilesia, ngjyra, pesha mesatare etj) dhe konfirmojnë që janë zbatuar masat e marra për ndarjen e produkteve.

5. Plani i transformimit dhe masat sipas pikave 1 dhe 2 janë aprovuar nga organizmi ose autoriteti inspektues. Ky aprovim duhet të konfirmohet çdo vit pas fillimit të planit të transformimit;

(a) në rastin e zonave të përcaktuara për kërkime shkencore bujqësore bihet dakort me autoritetin kompetent duke siguruar që janë plotësuar kushte 2, 3 dhe 4.

(b) në rastin e prodhimit të farave, materialeve shumuese vegjetative dhe fidanëve, sigurohet që janë plotësuar kushtet 2,3 dhe 4.

A. 2. Kafshët dhe produktet blektorale prodhuar nga ferma blektorale.

1. Kur sistemi i inspektimit zbatohet në produktet blektorale për herë të parë, prodhuesi dhe organizmi inspektues duhet të parashikojnë:

- një përshkrim të plotë të lokaleve të qëndrimit të kafshëve, lëndinave, kullotave etj, dhe sipas rastit, ambjentet e magazinimit, ambalazhimit dhe përpunimit të kafshëve, produkteve blektorale, lëndëve të para dhe faktorëve prodhues,

- një përshkrim të plotë të impiantit të grumbullimit të plehut organik,

- planin e shpërndarjes së plehrave të tilla në marrëveshje me organizmin inspektues ose autoritetin inspektues, sëbashku me një përshkrim të plotë të zonës së dhënë për prodhimin e bimëve,

- kur kërkohet, marrëveshjet sipas kontratës me forma të tjera në lidhje me shpërndarjen e plehrave,

- planin e menaxhimit për njësinë blektorale të prodhimit organik (psh. Menaxhimin për ushqyerjen, riprodhimin, shëndetin etj),

- të gjitha masat praktike që do të merren në fermën blegtorale për të garantuar plotësimin e dispozitave të këtij ligji.

Përshkrimet dhe masat e marra do te shenohen ne nje raport inspektimi te firmosur nga prodhuesi i interesuar. Per me teper, raporti duhet te specifikoj detyrimin e prodhuesit per kryerjen e operacioneve dhe , ne rast shkeljeje, aplikimin e masave administrative.

2.Kërkesat e përgjithshme të inspektimit në pikat 1 dhe 4 deri 8 të Pjeses A.1 që mbulojnë bimët dhe produktet blegtorale.
Duke u shmangur nga këto rregulla, është i lejuar përdorimi i produkteve mjeksore veterinare alopatike dhe antibiotikeve duke siguruar që ato janë dhënë nga një veteriner në lidhje me trajtimet sipas Shtojcës I, dhe janë ruajtur në një vend të kontrolluar si dhe janë shënuar në rregjistrin e fermës.

3 .Kafshët duhet të identifikohen në formë të përherëshme duke përdorur teknika të përshtatëshme për çdo specie, individuale në rastin e gjitareve të mëdhenj dhe individuale ose në grup në rastin e shpendëve ose gjitarëve të vegjël.

4.Të dhënat e kafshëve duhet të shënohen në një rregistër dhe të mbahen gjithmonë në dispozicion të autoritetit ose organizmave inspektuese në ndërmarrje.
Shënime të tilla, të cilat japin një përshkrim të plotë të sistemit të menaxhimit të kopesë, duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

- për çdo specie, në lidhje me kafshët që vijnë në fermë: origjinën dhe datën e ardhjes, periudhën e transformimit, shenjën identifikuese dhe shënimet veterinare;

- në lidhje me kafshët që largohen nga ferma: moshën, numrin e matrikullit, peshën në rastin e therjeve, shenjën identifikuese dhe destinacionin;

-hollësitë për çdo kafshë që humbet dhe arsyet;

-në lidhje me ushqimin: tipin, përfshirja e ushqimit shtesë, porcionet e përbërësve të ndryshëm të racionit dhe periudhat e futjes së zonave me hapësira të lira.

- Në lidhje me parandalimin e sëmundjeve, trajtimin dhe kujdesin veterinar: datën e trajtimit, diagnozen, tipin e produktit të përdorur, metodën e trajtimit dhe përshkrimin e mjekut për kujdesin veterinar me arsyet përkatëse dhe periudhën e përdorimit përpara shitjes së produkteve blegtorale.

5.Kur një prodhues menaxhon disa ferma blegtorale në të njëjtin rajon, njësitë të cilat prodhojnë kafshë ose produkte blegtorale, do ti nënshtrohen sistemit të inspektimit sipas përcaktimit të parë, dytë dhe tretë të pikës 1 të këtij seksioni në kafshë dhe produkte blegtorale si dhe programin e menaxhimit të kafshëve, rregjistrave të tyre dhe parimet e ruajtjes së produkteve të mbarështimit të kafshëve të përdorura.

B. Njësitë për përgatiijen e produkteve bimore dhe shtazore si dhe produkteve ushqimore që përmbajnë produkte bimore dhe shtazore.

1 .Kur rregjimi i inspektimit është aplikuar për herë të parë, prodhuesi dhe organizmi i inspektimit duhet të përpilojnë:

- një përshkrim të plotë të njësisë, duke treguar teknikat e përdorura për përpunimin, paketimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore përpara dhe pas përpunimit të tyre,

- të gjitha masat praktike të marra në nivel njësie për të garantuar zbatimin e këtij ligji.
Ky pershkrim dhe masat e lidhura me te duhet te jepen ne nje raport inspektimi te firmosur edhe nga personi pergjegjes i njesise.
Per me teper, raporti duhet te permbaje masat e marra nga operatori per te kryer operacionet sipas ligjit.

2.Rregjistri i shkruar duhet të mbahet në dispozicion të organizmit inspektues për:

- origjinën, natyrën dhe sasinë e produkteve bujqësore të cilat janë dorëzuar në njësi,

- natyrën, sasitë dhe destinacionin e produkteve që kanë lënë njësinë,

- çdo informacion tjetër që kërkohet nga organizmi i inspektimit për qëllime të inspektimit të përshtatshëm të operacioneve të tilla si origjina, natyra dhe sasitë e përbërësve, aditiveve dhe ndihmësve teknologjike të dhëna njësisë dhe përbërja e produkteve të përpunuara.

3.Kur produktet janë përpunuar, paketuar dhe ruajtur në një njësi sipas këtij ligji:

- njësia duhet të ndajë sipërfaqen në lokale për ruajtjen e produkteve, përpara dhe pas operacioneve,

- operacionet duhet të kryhen vazhdimisht deri në përfundimin e plotë të tyre të ndara fizikisht dhe në kohë nga operacione të ngjashme të kryera në produkte të pa përfshira në këtë ligj

- nëqoftëse operacione të tilla nuk kryhen shpesh, ato duhet të lajmërohen më përpara, në një kohë të vendosur sëbashku me organizmin inspektues,

- çdo masë duhet të merret për të garantuar identifikimin e partive dhe për të parandaluar përzjerjen me produktet që nuk merren në përputhje me rregullat e këtij ligji.

4. Përveç vizitave inspektuese të pa paralajmëruara, organizmi inspektues duhet të bëj një inspektim të plotë fizik, të paktën një herë në vit, të njësisë. Mund të merren mostra për testimtn e produkteve të pa autorizuara . Megjithatë, ato mund të merren kur dyshohet përdorimi i pa autorizuar i produkteve. Pas çdo vizite duhet të përpilohet një raport inspektimi i firmosur edhe nga personi përgjegjës për njësinë e inspektuar.

5. Operatori duhet ti japë organizmit inspektues, për qëllime inspektimi, akses për njesinë dhe rregjistrat e shkruara dhe sigurimin e dokumentacionit tjetër.

6. Produktet e dhëna në Nenin 1 mund të transferohen në njësitë e tjera, duke përfshirë tregëtinë me shumicë dhe pakicë, vetëm me amballazhim të përshtatshëm ose kontenierë të mbyllur në mënyrë që të parandalohet zëvëndësimi i përmbajtjes dhe të pajisur me etiketë ku shënohet pa paragjykuar tregues të tjerë të kërkuar nga ligji:

(a) emri dhe adresa e personit përgjegjës për prodhimin ose përgatitjen e produktit, ose, kur është përmendur një shitës tjetër, një deklarim i cili të tregojë njësinë matëse dhe organizmi inspektues të identifikoj pa ekuivoke personin përgjegjës për prodhimin e produktit;

(b) emrin e produktit duke përfshirë një referencë të metodës së prodhimit organik.
Me marrjen e një produkti , operatori do të kontrolloj mbylljen e amballazhit ose kontenierit dhe kur kërkohet edhe praninë e treguesve të dhënë në paragrafin e mësipërm, në piken A.8.1 ose ne piken C.8. Rezultati i këtij verifikimi do të shënohet në mënyrë të saktë në rregjistër sipas pikës B.2. Kur kontrolli lë ndonjë dyshim , ai vetëm mund ti nënshtrohet përpunimit ose amballazhimit pas eliminimit të këtij dyshimi, po të mos nxirret ne treg pa treguesin që i referohet metodës së prodhimit organik.

C. Eksportuesit e produkteve bimore, produkteve blegtorale dhe produkteve ushqimore që përmbajnë produkte bimore dhe / ose shtazore për në vendet e BE

1 .Kur rregullat e inspektimit janë zbatuar për herë të parë, eksportuesi dhe organizmi inspektues duhet të japin:

- një përshkrim të plotë të ambjenteve të eksportuesit dhe të aktiviteteve të tij, duke treguar sa është e mundur pikat e futjes së produkteve në Komunitet dhe çdo mjet tjetër që eksportuesi përdor për ruajtjen, magazinimin e produkteve të eksportuara;

- të gjitha masat praktike të marra nga eksportuesi për të garantuar zbatimin e këtij ligji

- Ky përshkrim dhe masat e marra duhet të përfshihen në raportin e inspektimit të firmosur nga eksportuesi.

Për më tepër, raporti duhet të përmbajë detyrimet e eksportuesit:

- të garantoj që çdo mjet apo mënyrë që eksportuesi përdor për ruajtje të jetë i hapur për inspektim, inspektimi që kryhet ose nga organizmi inspektues ose, kur këto magazina janë në një Shtet tjetër nga një organizëm inspektues i aprovuar për inspektim nga ky Shtet.

2. Duhet të mbahen rregjistra të shkruara që lejojnë organizmin inspektues të identifikojë për çdo parti produkti të eksportuar:

- origjinën, natyrën dhe sasinë e partisë në fjalë, dhe me kërkesë të organizmit inspektues çdo hollësi për mënyrën e transportit në lokalet apo magazinat e importuesit.

- origjinën, natyrën dhe destinacionin e partisë në fjalë, dhe me kërkesë të organizmit inspektues, çdo hollësi për mënyrën e transportit nga lokalet ose magazinat e importuesit në destinacion.

3.Eksportuesit duhet të informojnë organizmin inspektues për çdo ngarkesë të eksportuar në Komunitet, duke i dhënë hollësitë e kërkuara organizmit apo autoritetit, si një kopje të çertifikatës së inspektimit për produktet organike të importuara..

Kur produktet e importuara referuar në Nenin 1 ruhen në magazina ku produkte të tjera bujqësore ose produkte ushqimore janë përpunuar, amballazhuar ose magazinuar:

- produktet e referuara në Nenin 1 duhet të mbahen të ndara nga produktet e tjera bujqësore dhe / ose produktet ushqimore;

- duhet të merren masa për të garantuar identifikimin e partive të produkteve dhe parandalimin e përzjerjeve me produktet që nuk merren në përputhje me rregullat e këtij ligji.

3. Përveç vizitave inspektuese të paralajmëruara, organizmi inspektues duhet të bëj një inspektim të plotë fizik, të paktën një herë në vit, të lokaleve të eksportuesit. Organizmi Inspektues do të inspektoj rregjistrat e shkruara të përmendura në pikën C.2 dhe çertifikatat sipas ligjit. Mund të merren mostrat për testimin e e substancave të pa autorizuara në këtë ligj. Megjithatë, ato mund të merren kur dyshohet përdorimi i substancave të paautorizuara. Pas çdo vizite duhet të përpilohet një raport inspektimi, i firmosur edhe nga personi përgjegjës për njësinë e inspektimit.

4. eksportuesi duhet, për qëllime inspektimi, ti japi organizmit inspektues akses për lokalet e tij dhe për rregjistrat e shkruara dhe ta mbështesë me dokumenta të tjera, në veçanti çertifikatat eksportuese. Ai duhet ti sigurojë organizmit inspektues çdo informacion të domosdoshëm për qëllime inspektimi.

5. Produktet organike duhet të eksportohen me amballazhim ose kontenier të përshtatshëm, të mbyllur në mënyrë që të parandalojë zëvëndësimin e përmbajtjes dhe të siguruar me identifikimin e eksportuesit dhe me shenja të tjera dhe numrat që shërbejnë për të identifikuar partinë e mallit me çertifikatën e inspektimit.

ANEKSI IV

INFORMACIONI PËR NOTIFIKIMIN

(a) emri dhe adresa e operatorit
(b) vendndodhja e lokaleve dhe, kur kërkohet, ngastrat (data e rregjistrimit të tokës) ku kryhen operacionet
(c) natyra e operacioneve dhe produktet
(d) detyrimet e operatorit për kryerjen e operacioneve
(e) Në rastin e një ndërmarrjeje bujqësore, data në të cilin prodhuesi nuk përdor më në ngastrat e tij, aplikimin e produkteve përdorimi i të cilave nuk është në pajtushmëri me këtë ligj
(f) Emrin e organizmit të aprovuar të cilit operatori i ka besuar kontrollin e ndërmarrjes së tij, ku Shteti, ka zbatuar sistemin e inspektimit duke aprovuar organizma të tillë.

ANEKSI V

PJESA A: TREGUESI QË PRODUKTET JANË MBULUAR NGA SKEMA E INSPEKTIMIT

Treguesi që një produkt është mbuluar nga skema e inspektimit duhet të tregohet në të njëjtën gjuhë ose gjuhët e përdorura për etiketimin.
AL: Bujqësia organike - sistemi i kontrollit shqiptar
ES: Agricultura Ecologica - Sistema de control CE
DA: Øko1ogisk Jordbrug - EF- Kontrolordning
DE: Ökologischer Landbau - EG-Kontrollsystem oder Biologische Landwirtschaft - EG-Kontrollsystem
EL: ? ? ? ? ?
EN: Organic Farming - EC Control System
FR: Agriculture biologique - Système de contrôle CE
T: Agricoltura Biologica - Regime di controlloCE
NL: Biologische landbouw - EG-controlesysteem
PT: Agricultura Biol6gica - Sistema de Controlo CE
F: Luonnonmukainen maataloustuotanto - EY:n va1vontajärjestelmä
SV: Ekologiskt jordbruk - EG-kontrollsystem

PJESA B: LOGO KOMUNITETIT

B.1. Kushtet në lidhje me paraqitjen dhe përdorimin e logo-s së Komunitetit
B.1.1. Logo Komunitetit referuar më sipër do të përfshij modelet në pjesën B.2 të kësaj shtojce. B.1.2 Treguesit që duhet të përfshihen në logo janë listuar në pjesën B.3 të kësaj shtojce. Është e mundur të kombinohet logo me treguesin e përmendur në pjesën A të kësaj shtojce.
B.1.3 Për të përdorur logo-n e Komunitetit dhe treguesit e referuar në pjesën B.3 të kësaj shtojce, duhet të plotësohen rregullat e riprodhimit teknik të dhena në grafik manual në pjesën B.4 të kësaj shtojce

B.2. Modelet

ANEKSI VI

HYRJE

Për qëllime të kësaj Shtojce, do të përdoren përkufizimet e mëposhtëme:

1. Përbërësit me origjinë bujqësore:

(a) produktet bujqësore të thjeshta dhe produkte të marra prej tyre nga larja, pastrimi, përpunimi termik dhe/ose mekanik i përshtatshëm dhe/ose nga përpunime fizike duke ndikuar në reduktimin e përmbajtjes së lagështirës së produktit;
(b) gjithashtu, produktet e rrjedhura nga produktet e përmendura në pikën (a) nga proçese të tjera të përdorura në përpunimin e ushqimit, por vetëm se këto produkte janë konsideruar si shtesa ushqimore ose aromatizues

2. Përbërësit me origjinë jobujqësore: përbërës të ndryshëm nga ato me origjinë bujqësore dhe që i përkasin të paktën një nga kategorive të mëposhtëme:

3. 1. Shtesa ushqimore, duke përfshirë bartësit e shtesave ushqimore
3 .2. Aromatizuesit,

3.3. uji dhe kripa;

3.4. preparatet e mikro-organizmave;

3.5. mineralet (duke përfshirë elementet gjurmë) dhe vitaminat.

4.Mbartësit, duke përfshirë mbartësit e solventëve: shtesat ushqimore të përdorura për të tretur, holluar, shpërndarë ose për të modifikuar fizikisht një shtesë ushqimore pa ndryshuar funksionin teknologjik të tij me qëllim që të lehtësojë përpunimin, aplikimin ose përdorimin e tij;

PARIME TË PËRGJITHSHME

Seksionet A,B dhe C përfshijnë përbërësit dhe lëndët ndihmëse të përpunimit të cilat mund të përdoren në përgatitjen e produkteve ushqimore të përbëra kryesisht nga një ose më shumë përbërës me origjinë bimore, me përjashtim të verërave.
Përpara adoptimit të rregullave në Seksionet A dhe B të kësaj Shtojce, dhe me qëllim që të përfshihet në mënyrë specifike përgatitja e produkteve ushqimore të përbëra nga një ose më shumë produkte blegtorale, do të zbatohen rregullat kombëtare.
Megjithatë, referenca për çdo përbërës të Seksioneve A dhe C ose çdo lëndë ndihmëse të përpunimit të Seksionit B, çdo praktike përpunimi, të tillë si tymosja, do të përdoren vetëm në përputhje me legjislacionin Komunitar dhe/ose legjislacionin kombëtar, dhe në mungesë të tyre, në përputhje me parimet e praktikës së mirë të prodhimit për produktet ushqimore.

SEKSIONI A - PËRBËRËSIT ME ORIGJINË JO BUJQËSORE

Emri		Kushtet specifike
E 170	Karbonat kalciumi	Autorizohen të gjitha funksionet përveç ngyrimit
E 270	Acid laktik	

E 290	Dyoksid karboni	
E 296	Acid malik	
E300	Acidaskorbik	
E 306	Ekstrakt i asur i tokoferolit	Antioksidant në yndyrna dhe vajra
E 322	Lecitina	
E 330	Acid citrik	
E 333	Citrat kalciumi	
E 334	Acid tartrik (L(+)-)	
E335	Tartrat natriumi	
E 336	Tartrat kaliurni	
E 341 (i)	Monofosfat kalciumi	Agjent rritës për vetërritjen në miell
E 400	Acid algjinik	
E 401	Alginat natriumi	
E 402	Alginat kaliumi	
E406	Agar	
E 407	Karagenan	
E410	*Locust bean gum*	
E412	*Guar gum*	
E 413	*Tragacanth gum*	
E 414	Goma arabike	
E 415	Goma xanthan	
E416	Karaga gum	
E 422	Glicerol	Ekstrakt bimor
E 440(i)	Pektin	
E 500	Karbonat natriumi	
E 501	Karbonat kaliumi	
E 503	Karbonat amoni	
E 504	Karbonat magnezi	
E 5 16	Sulfat kalciumi	Mbartës
E 524	Hidroksid natriumi	Trajtues i sipërfaqes i Laugengebäck
E 551	Dioksid silici	Agjent kundër pjekjes për erëzat
E938	Argon	
E941	Azot	
E 948	Oksigjen	

A.2• Aromatizuesit të etiketuara si substanca aromatizuese natyrale

A.3. Uji dhe kripa

Uji i pishëm.

Kripa (me komponentë bazë klorurin e natriu mit ose klorurin e kaliu mit), në përgjithësi të përdorura në përpunimin e ushqimit.

A4• Preparatet e mikro-organizmave

Çdo preparat i mikro-organizmave normalisht i përdorur në përpunimin e ushqimeve, me përjashtim të mikro-organizmave gjenetikisht të modifikuara

A5• Mineralet (duke përfshirë edhe elementët gjurmë), vitaminat, aminoacidet dhe komponimet e tjera të azotit: Mineralet (duke përfshirë edhe elementet gjurmë), vitaminat, aminoacidet dhe komponimet e tjera të azotit janë të lejueshme vetëm nqs përdorimi i tyre është i lejuar me ligj në produktet ushqimore ku ato janë përfshirë.

SEKSIONI B - LËNDËT NDIHMËSE TË PËRPUNIMIT DHE PRODUKTE TË TJERA TË CILAT MUND TË PËRDOREN PËR PËRPUNIMIN E PËRBËRËSVE ME ORIGJINË BUJQËSORE NGA PRODHIMI ORGANIK

Emri	***Kushtet specifike***
Ujë	
Klorur kalciumi	Agjent koagulues
Karbonat kalciumi	
Hidroksid kalciumi	
Sulfat kalciumi	Agjent koagulues
Klorur magnezi (ose nigar)	Agjent koagulues
Karbonat kaliumi	Tharës i rrushit
Karbonat natriumi	Prodhim sheqeri
Hidroksid natriumi	prodhim sheqeri Prodhim vaji nga farat e pjekura (Brassica spp)
Acid sulfurik	Prodhim sheqeri
Izopropanol (propan-2-ol)	Në proçesin e kristalizimit në prodhimin e sheqerit Për një[...] periudhë deri më 31.12.2006
Dyoksid karboni	
Azot	
Etanol tretës	
Acid tanik	Për qëllime filtrimi
Albumina tek e bardha e vezës	
Kazein	
Xhelatin	
Vajra vegjetal	Agjent lubrifikues, çlirues ose antishkumues
Dyoksid silici	Xhel ose tretësirë koloidale
Karbon aktiv	
Pudër	
Bentonit	
Kaolin	
Tokë diatomike	
Perlite	
Lëvozhga e lajthisë	
Miell orizi	
Dyll blete	Agjent çlirues
Carnauba wax	Agjent çlirues

Preparatet e mikro-organizmave dhe enzimave:

Çdo preparat i mikro-organizmave dhe enzimave normalisht të përdorur si lëndë ndihmëse në përpunimin e ushqimeve, me përjashtim të organizmave gjenetikisht të modifikuar

SEKSIONI C. PËRBËRËSIT ME ORIGJINË BUJQËSORE TË CILAT NUK JANË PRODHUAR ORGANIKISHT,

C1. produktet bimore të papërpunuara si dhe produktet e rrjedhura prej tyre nga përpunimi sipas përkufizimit 2(a) të hyrjes së kësaj Shtojce:

C1 . 1. Frutat dhe farat e ngrënëshme:

Lende	Quercus spp.
Arra cola	Cola acuminata
Rrush frëngu	Ribes uva-crispa
Frut pasioni	Passiflora edulis
Manaferre (e tharë)	Rubus idaeus
Stafidhe e kuqe (e tharë)	Ribes rubrum

C1.2. Erëzat dhe barërat e ngrënëshme:

Arrë hindri	Myristica fragrans, deri më 31.12.2000
Piper jeshil	Piper nigrum, deri më 30.4.2001
Piper (Peruvian)	Schinus molle L.
Fara rrepe	Armoracia rusticana
Lesser galanga	Alpina officinarum
Saff1ower f1ower	Carthamus tinctorius
Watercress herb	Nasturtium officinale

C1.3. Të ndryshme: alga, duke përfshirë leshterikët, të lejuara në përgatitjen e produkteve ushqimore konvencionale

C.2. Produkte bimore, të përpunuara nga proçese sipas përkufizimit të pikës 2(b) të hyrjes së kësaj Shtojce

C.2. 1. Yndyrnat dhe vajrat të ose jo rafinuara, por jo të modifikuara kimikisht, të marra nga bimë të ndryshme se:

Kakao	Theobroma cacao
Arrë kokosi	Cocos nucifera
Ulli	Olea europaea
Lule dielli	Helianthus annuus
Palm	Elaeis uineensis
Rrepe	Brassica napus, rapa
saff1ower	Carthamus tinctorius
Susam	Sesames indicum
Soja	Glycine max

C.2.2. Sheqerërat, niseshteja dhe produkte të tjera të marra nga drithërat dhe bimët zhardhokore:

Sheqer nga panxhar sheqeri,
Fruktoze
Flete orizi
Bukë pa maja
Niseshte nga orizi dhe misri, të pamodifikuara kimikisht.

C.2.3. Të ndryshme

Coriander, i tymosur	Coriandrum sativum deri me 31.12.2000
Protein bizeleje	Pisums

- Rum, i marrë vetëm nga lëngu i kallam sheqerit
- Kirsch, i përgatitur në bazë të frutave dhe aromatizuesve sipas Seksionit A.2. të kësaj Shtojce.
    - Përzjerje e bimëve e lejuar në përgatitjen e produkteve ushqimore konvencionale dhe duke i dhënë cilësitë e ngjyrës dhe shijes së ëmbëlsirave, vetëm në përgatitjen e "Gummi Bärcheu",
    - Përzjerje të pipereve: piper nigrum, Schinus molle dhe Schinus terebinthifolium,

C.3. produkte shtazore:

- organizmat ujore, që nuk rrjedhin nga akuakultura, dhe lejohen në përgatitjen e produkteve ushqimore konvencionale
- gjalpqumështi pluhur,
- xhelatin
- mjaltë,

ANEKSI VII

Numri maksimal i kafshëve per ha ***Klasa ose speciet***	***Numri maksimal i kafshëve per ha*** ***Ekuivalent për 170 k N/ha/vit***
Njëthundrak mbi 6 muaj	2
Viça për majmëri	*5*
Gjedhë te tjerë më të vegjël se një vit	*5*
Gedhë meshkuj nga l deri në 2vjeç	3.3
Gjedhë femra n a 1 deri ne 2 vjeç	3.3
Gjedhe meshkuj 2 ose mbi 2 vjeç	2
Mëshqerra riprodhuese	2.5
Mëshqerra er majmeri	*2.5*
Lopë për qumësht	2
Lopë qumështi për reformim	2
Lopë të tjera	2.5
Lepuj riprodhimi	100
Dele	13.3
Dhi	13.3
Derra	74
Dosa riprodhimi	6.5
Derra për majmëri	14
Derra të tjerë	14
Pula për tavolinë	5 80
Pula për vezë	230

ANEKSI VIII

Sipërfaqet minimale të mbuluara dhe të pambuluara dhe karakteristikat e tjera të vendodhjes për specie dhe tipe të ndryshme prodhimi.

1.GJEDHET, DELET DHE DERRAT

		Sipërfaqja e mbuluar (siperfaqja neto e disponueshme për kafshët)	Sipërfaqet e zbuluara (sipërfaqet e lira, duke përfshirë kullotat)
	Pesha e gjallë minimale (kg)	M^2/kokë	M^2/kokë
Gjedhët dhe njëthundrak për riprodhim dhe majmëri	Deri në 100 Deri në 200 Deri në 350 Deri në 350	1.5 *2.5* 4.0 5 me një minimum 1 m^2/100 kg	1.1 1.9 3 3.7 me një minimum 0.75 m^2 /100 kg
Lopë qumeshti		6	4.5
Dema për riprodhim		10	30
Dele dhe dhi		1.5 dele/dhi 0.35 qingja/keca 2.5	2.5 0.5 për qingja/keca
Dosa me gica deri në 40 ditë		7.5 dosa	2.5
Derra për majmëri	Deri në 50 Deri në85 Deri në 110	0.8 1.1 1.3	0.6 0.8 1
Derra	Mbi 40 ditë dhe mbi 30kg	0.6	0.4
Gica		2.5 femër 6.0 mashkull	1.9 8.0

2. SHPENDËT

	Siperfaqja e mbuluar (siperfaqja neto e disponueshme për kafshët)			Sipërfaqet e zbuluara (sipërfaqet e lira në m^2 në qarkullim/kokë No)
	Kafshë/m^2	cm furrik/kafshë	Fole	
Pula për vezë	6	18	8 pula për fole ose në rastin e foleve të përbashkëta 120 cm^2/zog	4, duke siguruar që nuk kalohet kufiri 170 kg të N/ha/vit
Shpendë për majmëri (në strehim fiks)	10 me një maksimum 21 kg peshë e gjallë/m^2	20 (vetëm për kafshë shtëpiake)		4 zogj për mish dhe kafshë shtëpiake 4.5 rosa

				10 gjela deti 15 pata Për të gjitha speciet e përmendura më sipër nuk duhet të kalohet kufiri 170 kg të N/ha/vit.
Shpendë për majmëri (në strehim të lëvizshëm)	16 (*) në strehim të lëvizshëm shpendësh me një maksimum 30 kg peshë e gjallë/ m^2			2.5, duke siguruar që të mos kalohet kufiri i 170 kg të N/ha/vit

(*) vetëm në rastet e strehimeve të lëvizshme nuk duhet të kaloj 150 m^2 sipërfaqe dyshemeje të cilat mbeten hapur natën.